Në tërësinë e tij, dokumenti i “Standardeve minimale për shërbimet e përkujdesjes shoqërore për personat LGBTI+ në qendrat rezidenciale publike dhe jopublike, në Shqipëri” shtjellon unikalitetin e shërbimit gjithëpërfshirës dhe jodiskriminues për komunitetin LGBTI+, bazuar

në nevojat specifike të këtij komuniteti. Për rrjedhojë, ky dokument mund të shërbejë edhe si një model për të gjithë ofruesit e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore në qendrat rezidenciale publike e jopublike, të cilat mund të jenë më përfshirëse për personat LGBTI+, duke u shndërruar në shërbime kulturalisht kompetente dhe me standarde të përshtatura për përfshirjen dhe ofrimin e kujdesit për personat LGBTI+ dhe respektimin e diversitetit në shërbimet ndaj tyre.

Të gjitha/ë profesionistët/profesionistët të cilat/cilët angazhohen në ofrimin e shërbimeve për personat LGBTI+ duhet të jenë të mirinformuar dhe të trajnuar për t’u përgjigjur në mënyrën e duhur nevojave të këtij komuniteti, duke pasur parasysh veçantitë e anëtarëve të tij. Shërbimet e kujdesit shoqëror në qendrat rezidenciale për personat LGBTI+ duhet të reflektojnë jo vetëm plotësimin e standardeve minimale, por edhe avancimin drejt përmirësimit të tyre. Gjithashtu duhet të mbështeten në një tërësi parimesh bazë universale, që theksojnë rëndësinë e respektimit dhe të pranimit të diversitetit, mosdiskriminimit, të drejtave, zgjedhjeve dhe dinjitetit njerëzor, duke synuar përmirësimin e sigurisë, efektivitetit dhe eficiencës së shumëllojshmërisë së shërbimeve, sipas nevojave të personave LGBTI+. Njohja dhe të kuptuarit në mënyrën e duhur të një tërësie konceptesh bazë, që karakterizojnë të punuarit në këtë drejtim, shtjellimi i të cilave përditësohet vazhdimisht në literaturën ndërkombëtare, është gjithashtu domosdoshmëri.

II. PARIMET UDHËHEQËSE

Shërbimet ndaj personave LGBTI+ si pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror për këtë komunitet, bazohen në filozofinë dhe parimet e legjislacionit dhe politikave shtetërore në fuqi, sidomos në ligjin nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” (ku përkufizimet mbi shërbimet dhe parimet e përgjithshme jepen respektivisht në nenet 3 dhe 4 të këtij ligji).

Megjithatë, duke pasur parasysh veçantitë dhe nevojat e këtij komuniteti, është e rëndësishme që krahas parimeve të cituara në ligjin nr. 121/2016, të theksohet se shërbimet e përkujdesjes që ofrohen në qendrat rezidenciale për personat LGBTI+ apo kur persona LGBTI+ marrin shërbime duhet të bazohen edhe mbi këto parime:



Parimi për të gëzuar universalisht të drejtat e njeriut. Të gjitha qeniet njerëzore kanë lindur të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe të drejta. Qeniet njerëzore të të gjitha orientimeve seksuale dhe të identiteteve gjinore kanë të drejtën e gëzimit të plotë të të gjitha të drejtave të njeriut.

Parimi për të gëzuar mbrojtje nga shteti. Të gjithë personat në një shoqëri, pavarësisht nga orientimi seksual, identiteti gjinor, shprehja gjinore ose karakteristikat e seksit, kanë të drejtë të gëzojnë mbrojtjen e shtetit nga dhuna, diskriminimi dhe dëmtime të tjera, qoftë nga ana e punonjësve të shtetit, qoftë nga ndonjë individ apo grup i caktuar.

Parimi i mosdiskriminimit si pikënisje bazë në ofrimin e shërbimeve, përforcuar nga parimi i afirmimit/pohimit dhe i respektit për identitetin personal. Të gjitha qeniet njerëzore kanë të drejtë për trajtim të barabartë pavarësisht nga mosha, gjinia, raca, feja, kombësia, etnia, orientimi seksual apo çdo karakteristikë tjetër. “Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim apo pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi¹.

Afirmimi është një mënyrë e të kuptuarit dhe e të krijuarit të hapësirave të sigurta për të gjithë njerëzit. Afirmimi është i rëndësishëm gjatë gjithë jetës. Personat LGBTI+ shpesh kanë frikë se mund të abuzohen ose se nuk do të mund të marrin kujdes, sipas standardeve, nëse janë të hapur për identitetin e tyre. Kjo frikë mund t'i shtyjë ata të fshehin orientimin seksual ose identitetin gjinor,

duke i shkëputur kështu nga komuniteti i tyre dhe nga afirmimet e rëndësishme për historinë dhe përvojën e tyre. Përqendrimi në afirmim na lejon të kuptojmë se çfarë mund të bëjë mungesa e tij për ndjenjën e vetvetes të një personi dhe cilësinë e kujdesit të tij – veçanërisht kur njerëzit rriten dhe kanë nevojë për marrëdhënie të reja dhe forma të ndryshme të kujdesit². Pra, koncepti i afirmimit është një formë aktive e shprehjes së identitetit dhe, në kontekstin e komunitetit LGBTI+, ai lidhet sidomos me problematikën e “fshehjes” së personave LGBTI+ apo të statistikave rreth tyre, në shërbime të ndryshme.

Parimi i të mësuarit të vazhdueshëm buron nga aftësia e brendshme organizative dhe kulturore e shërbimit për të përmirësuar veten, duke identifikuar nevojat për përmirësim, duke inkurajuar ose duke mbështetur stafin të trajnohet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke monitoruar nivelin e përmirësimit.

Parimi i sigorisë, dinjitetit, diversitetit dhe aksesit në shërbime. Të gjitha ndërhyrjet për personat LGBTI+ për ngritjen apo ofrimin e çdo shërbimi të përkujdesjes shoqërore në qendrat rezidenciale, duhet t'i japin përparësi sigorisë dhe dinjitetit të përdoruesve të shërbimit dhe personelit. Gjatë ofrimit të këtyre shërbimeve është e rëndësishme të respektohet diversiteti dhe aksesit për të gjithë personat LGBTI+, në varësi edhe të nevojave të tyre. Çdo plan individual që përgatitet në strehës, me qëllim adresimin e situatës së një personi LGBTI+ në nevojë për mbështetje dhe për ndihmë, duhet patjetër të ketë si faktor kryesor sigurinë e tyre.

Parimi i ndërlidhjes së individit me familjen dhe shoqërinë. Ky parim nënkupton një rol unik për secilin individ apo pjesë të sistemit, në funksion të sistemit, me idenë se çdo veprim i njërit ndikon mbi gjithë sistemin. Kjo krijon mundësinë që rastet të trajtohen me ndërgjegjësimin që ato janë unike, sepse përfaqësojnë unikalitetin e çdo sistemi familjar. Gjithashtu, kjo siguron edhe që në trajtimin e rasteve të mirëkuptohen nënshtresa të tjera që formësojnë dhe shpjegojnë një sistem familjar. Për shembull, nëse realiteti i një individi mund të kuptohet në kontekst me sistemin e tij

¹ Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 3. Shiko: <http://www.sherbimisocial.gov.al/ep-content/uploads/2017/02/ligj.1212016.pdf>

² <https://scholars.org/contribution/affirmation-way-understand-and-create-safe-spaces-all-people>



familjar, ky sistem nga ana tjetër mund të kuptohet vetëm në kontekstin më të gjerë shoqëror.

Parimi që rritja personale mund të jetë një pasojë e natyrshme për çdo individ që kalon një traumë.

Parimi i fuqizimit. Krijimi i një atmosfere ku përfituesit e shërbimit ndihen të vlerësuar dhe kanë kontroll mbi ambientin dhe ndihmën e planifikuar apo të dhënë. Parimi i fuqizimit nënkupton që marrëdhëniet përfitues–profesionist vendosen mbi bashkëpunimin dhe besimin, dhe duke u fokusuar te pikat e forta të përfituesit.

Parimi i konfidencialitetit dhe i mbrojtjes së të dhënave personale. Të dhënat personale të personave LGBTI+, të cilët trajtohen në shërbimin rezidencial të strehimit, janë konfidenciale dhe mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Profesionistët dhe profesionistët e angazhuar në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat rezidenciale për personat LGBTI+ kanë detyrim për ruajtjen e konfidencialitetit edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës.

Parimi “Mos lëndo!” dhe vendosja e personit LGBTI+ në qendër të shërbimit. Parimi “Mos lëndo!” sjell në vëmendje faktin që ndihma e ofruar dhe mënyra se si administrohet, mund të shkaktojë dëm ose mund të forcojë kapacitetet e personave LGBTI+. Prandaj është shumë e rëndësishme për ofruesit e shërbimeve të arrijnë të kuptojnë kontekstin në të cilin ka nevojë të ofrohet ndihmë dhe më pas të veprojnë në bazë të të kuptuarit të këtij konteksti, për të shmangur pasojat negative në veprimet e tyre. Gjithashtu, në filozofinë e ofrimit të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për personat LGBTI+ në qendrat rezidenciale, me fokus shërbimin e specializuar të strehimit, duhet të mbahet në konsideratë rëndësia e pasjes së personave LGBTI+ në qendër të sistemit dhe reagimeve – me fjalë të tjera, ofrimi i shërbimeve në bazë të nevojave e prioritetëve të tyre.

III. TERMAT DHE TERMINOLOGJIA

“LGBTI+”, ky është akronimi për “lezbike, gej, biseksual, transgjinnor, interseks etj.”. Duhet të kemi parasysh që me kalimin e kohës dhe me zhvillimet që shoqëria dhe gjuha pëson, kjo listë akronimesh është pasuruar dhe zgjeruar.

“SOGIEC”, një term ombrellë, më i gjerë se sa LGBTI+, që nënkupton: “orientimi seksual, identiteti dhe shprehja gjinore, dhe karakteristikat e seksit”, të cilat veç shtjellimit të mësipërm, mund të përmbledhen më thjesht, si në vijim: Ndërsa orientimi seksual është në vetvete një markues që identifikon tërheqjen e qëndrueshme romantike, emocionale dhe seksuale, identiteti gjinor është një koncept i brendshëm për vetveten si mashkull ose si femër, ose për disa individë si një ndërthurje e të dyjave, ose e asnjërës (pra mënyra si individ i koncepton veten, koncept që mund të jetë i ndryshëm nga gjinia/seksi që e shoqëron në dokumente ligjore). Shprehja gjinore nga ana tjetër, është një sjellje e individit për t’u komunikuar jashtë vetes. Është mënyra si individ zgjedh ta bëjë të ditur identitetin e vet, përmes sjelljes, veshjes, modelit të flokëve apo zërit dhe që mund ose mund të mos përputhet me normat apo sjelljet e përkufizuara sociale që kërkojnë një pozicionim strikt ose mashkullor, ose femëror. Së fundmi, “karakteristikat e seksit” është një togfjalësh që synon të identifikojë personat që lindin me karakteristika primare dhe dytësore seksuale të ndryshme nga ato të femrës apo të mashkullit (personat interseks).

“Lezbike”, një grua ose vajzë e cila tërhiqet emocionalisht, fizikisht dhe seksualisht nga një grua tjetër.

“Gej”, një mbiemër që ka zëvendësuar gjerësisht fjalën “homoseksual” kur u referohemi meshkujve që janë seksualisht dhe emocionalisht të tërhequr nga meshkuj të tjerë.

“Biseksual”, individët që tërhiqen emocionalisht dhe seksualisht nga të dyja sekset. Nuk supozon ose hamendëson jomonogami. Disa njerëz identifikohen si “bi” në vend të biseksualë.

“Transgjinnor”, termi transgjinnor përdoret si një term ombrellë për personat që e ndiejnë ose e shprehin gjininë e tyre ndryshe nga pritshmëritë e shumicës bazuar në seksin e tyre biologjik. Ky grupim mund të përfshijë personat transeksualë ose ata që vishen “ndryshe”.

“Interseks” është një term i përgjithshëm që përdoret për kushte të ndryshme, kur një person lind me një anatomi të caktuar seksuale dhe të organeve të riprodhimit, që nuk përputhet me përcaktimin tipik mashkull/femër. Ndërveprimi midis kategorizimeve sociale të ndryshme të lidhura me racën, statusin shoqëror, gjininë, orientimin



seksual, identitetin gjinor që çojnë në një mbivendosje të mundësive për të përjetuar diskriminim apo për të qenë i disavantazhuar, për shembull kur një person i përket etnisë rome dhe është LGBTI+.

“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë ose me çdo shkak tjetër që ka si qëllim apo pasojë pengesën, apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

“Heterosexism”, qëndrime diskriminuese apo paragjyquese ndaj personave homoseksualë bazuar mbi përgjithësimin që heteroseksualiteti është orientimi normal seksual.

“Homofobi”, ky term i referohet frikës, zemërimit, urrejtjes, mostolerimit dhe mospranimi të personave LGBTI.

“Gabimi i gjinisë (*Misgendering*)” ndodh atëherë kur një ofrues shërbimi aludon gjininë e gabuar për dikë, me apo pa dashje. Në terma të ofrimit të shërbimeve, kjo mund të ndikojë negativisht te përfituesi/përfituesja që merr shërbimin.

“Dalja hapur/dalja nga dollapi”, procesi i njohjes, ndërjegjësimit dhe pranimi të orientimit joheteroseksual ose identitetit gjinor me veten dhe pastaj ndarja me të tjerët. Dalja hapur zakonisht ndodh me etapa, dhe është një proces jolinear.

“Diversitet”, parimi që çdo person është i veçantë dhe pranimi i diferencave në terma të racës, etnicitetit, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, statusit socio-ekonomik, moshës, aftësive fizike, besimeve fetare, ideologjive politike dhe ideologjive të tjera.

“Shërbime afirmuese”, lloji dhe modeli i shërbimeve ku diversiteti i orientimit seksual, identitetit gjinor, shprehjes gjinore dhe karakteristikave seksuale shikohet si një variacion pozitiv i identitetit seksual të personit.

“Shërbimet e informuara për traumën”, shërbime ku njihet prania e simptomave të traumës te stafi dhe përfituesit dhe pranohet roli që trauma mund të ketë në mirëqenien e individit.

“Parimi i vetëpërcaktimit”, parimi sipas të cilit autoritetin për përcaktimin e çdo shtrese të identitetit vetjak të individit (përfshirë përdorimin e përemrave gjinorë) e ka vetë individi dhe jo shteti apo shoqëria.

“Identiteti gjinor”, identiteti gjinor është përvoja jonë e brendshme dhe emërtimi i përkatësisë sonë gjinore. Mund të korrespondojë ose të ndryshojë nga seksi që na është caktuar në lindje. Kuptimi i gjinisë sonë vjen për shumicën prej nesh mjaft herët në jetë. Identiteti gjinor është një aspekt i qenësishëm i përbërjes së një personi. Individet nuk zgjedhin gjininë e tyre dhe as nuk mund ta ndryshojnë atë. Sidoqoftë, fjalët që dikush përdor për të komunikuar identitetin e tyre gjinor mund të ndryshojnë me kalimin e kohës; emërtimi i gjinisë së dikujt mund të jetë një çështje komplekse dhe në zhvillim. Për shkak se ne kemi një gjuhë të kufizuar për përkatësinë gjinore, një personi mund t’i duhet mjaft kohë për ta zbuluar ose krijuar, gjuhën që komunikon më së miri përvojën e tij të brendshme. Po kështu, ndërsa gjuha evoluon, emri i një personi për përkatësinë gjinore të tij, gjithashtu, mund të zhvillohet. Kjo nuk do të thotë se gjinia e tij ka ndryshuar, por përkundrazi fjalët për të po ndryshojnë. Dy identitetet gjinore me të cilat njerëzit janë të njohur janë djem/burra dhe vajza/gra dhe shpesh njerëzit mendojnë se këto janë identitetet e vetme gjinore. Kjo ide se ekzistojnë vetëm dy gjini – dhe që secili individ duhet të jetë ose njëra ose tjetra – quhet “binari gjinor”. Sidoqoftë, gjatë gjithë historisë njerëzore ne e dimë se shumë shoqëri kanë parë dhe vazhdojnë ta shohin gjininë, si një spektër dhe jo të kufizuar në vetëm dy mundësi. Përveç këtyre dy identiteteve, identitetet e tjera tani janë të zakonshme. Më shumë se sa thjesht një seri fjalësh të reja, megjithatë, ky ndryshim në gjuhë, përfaqëson një kuptim shumë më të nuancuar të përvojës së vetë gjinisë. Termat që komunikojnë gamën e gjerë të përvojave të njerëzve jobinarë janë veçanërisht në rritje në numër.

“Genderqueer” një term që përdoret si identitet ashtu edhe si term ombrellë për identitetet jobinare, është një shembull i një termi për ata që nuk



identifikohen si ekskluzivisht mashkullorë apo femërorë.

“Dimensionet e ‘përkatësisë gjinore’³: Njerëzit kanë tendencë të përdorin termat “seks” dhe “përkatësi gjinore”, në mënyrë të njëjtë apo si zëvendësim i njëri-tjetrit. Por, ndërsa janë të lidhur, të dy termat nuk janë ekuivalentë. Në përgjithësi, ne caktojmë seksin e një të porsalindur si mashkull apo femër, bazuar në organet gjinitale të foshnjës. Pasi caktohet një seks, ne supozojmë përkatësinë gjinore të fëmijës. Për disa njerëz, kjo gjë nuk përbën ndonjë shqetësim apo mendim të mëtejshëm, sepse përkatësia gjinore e tyre përputhet me idetë dhe supozimet e lidhura me seksin e tyre. Sidoqoftë, ndërsa përkatësia gjinore mund të fillojë me caktimin e seksit tonë, në fakt nuk mbaron këtu. Përkatësia gjinore e një personi është ndërlidhja e ndërlikuar midis tri dimensioneve: trupit, identitetit gjinor dhe përkatësisë gjinore sociale.

IV. DHUNA DHE KOMUNITETI LGBTI+

Sipas ligjit nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”: “Viktima të dhunës” janë të gjithë individët, grupet e individëve apo familjet, të cilat janë viktime dhe/ose viktime të mundshme të dhunës, përfshirë dhunën në familje ose abuzimet, sipas legjislacionit në fuqi.

Nevoja për përkufizimin e dhunës te personat LGBTI+

Në këtë dokument propozohet një përkufizim i zgjeruar i konceptit të dhunës ndaj personave LGBTI+, me synimin që ky përkufizim t’u vijë në ndihmë ofruesve të shërbimeve, politikëbërësve, vetë komunitetit LGBTI+, institucioneve publike dhe jopublike, institucioneve ligjzbatuese dhe çdo aktori shoqëror. Përkufizimi i dhunës bëhet për dy arsye kryesore:

Së pari, pasja e një përkufizimi të ri që shkon përtej atyre ekzistuese, që mund të jenë pjesë e

kurrikulave mësimore apo e procesit të raportimeve pranë strukturave të rendit, bëhet për të hedhur dritë mbi dimensionin e dhunës që i tejkalon kornizat e ngushta teknike. Ky përkufizim na jep mundësinë për ta parë panoramën në mënyrë më të plotë dhe përfshirëse, e për pasojë, na aftëson të identifikojmë në një mënyrë më të saktë popullatën rreth së cilës do të duhej të ndërtoheshin shërbimet. E thënë më shkurt, duke pasur një përkufizim të tillë për dhunën, atëherë ne dimë edhe profilin e popullatës për të cilën ndërtojmë shërbime.

Së dyti, pasja e një përkufizimi të plotë për të gjitha dimensionet e dhunës i jep mundësi çdo ofruesi shërbimesh të identifikojë mangësitë dhe të parashikojë ndërhyrjet e mundshme për të rritur cilësinë e shërbimeve.

Dhuna ndaj komunitetit LGBTI+. Një individ LGBTI+ mund të jetë viktimë direkte e abuzimit fizik, psikologjik, emocional, seksual (përfshirë dhunën dhe/ose ngacmimin seksual), verbal, financiar, socio-kulturor dhe/ose përjashtim (ose kërcënim për përjashtim) nga trashëgimia materiale, apo/dhe kujtesa dhe narrativa familjare, ose mund të jetë subjekt i kërcënimeve për bërje publike të informacioneve private, ose kërcënimit për abuzim, ndaj tyre ose ndaj fëmijëve biologjikë, ose atyre të adoptuar, apo ndaj kujtdo familjari tjetër, ose mund të kërcënohet ose të jetë viktimë e shkatërrimit të çdo lloji prone. Kërcënimet për dhunë apo dhuna mund të ndodhin në familje, në komunitet, në shkollë, në punë apo në rrugë, në rrjete sociale apo në median tradicionale, në institucione private apo publike, në ambiente private apo publike, nga familjarë ose nga të afërm, ose nga të njohur apo të panjohur, ose nga të dashurit/partnerët apo ish-të dashurit/ish-partnerët, bashkëshortët/ish-bashkëshortët, apo/ose bashkëjetuesit, ofruesit e shërbimeve, punonjës të administratës, edukatorët, mjekët, infermierët, policët, kolegët, gazetarët, apo/dhe nga kushdo tjetër në mënyrë sistematike, të izoluar apo rastësore, me paramendim apo pa paramendim. Kërcënimi apo shtrëngimi për të mos e ekspozuar orientimin seksual, identitetin gjinor, shprehjen gjinore apo karakteristikat seksuale në publik është, gjithashtu, një formë e dhunës ndaj personave LGBTI+.

³ Bëhet fjalë për termin “gender” – “gjin”, por në Shqipëri prej vitesh nuk është përdorur saktësisht si terminologji, pasi vetë ky term ka zëvendësuar më shumë termin “seks” (pra është përdorur zakonisht “gjinia” = mashkull/femër). Prandaj, për të bërë dallimin mes tij dhe asaj që në sintaksë e kemi formuluar si “mashkullorë” apo “femërore” (duke e emërtuar sërish “gjin”), si dhe “mashkullorësisë” e “feminilitetit” që shoqëron konceptet djalë/burrë apo vajza/grua, ekspertet/ekspertët e fushës, prej vitesh kanë dakordësuar që në çështjet e barazisë gjinore, termin “gender” ta përkthejnë “përkatësi gjinore”.



V. GRUPI I SYNUAR DHE PRAKTIKA PREMTUESE

Përfituesit e synuar

Përfituesit e synuar janë personat LGBTI+ viktimë të formave të dhunës të paraqitura në hyrjen e këtij dokumenti. Nga ana tjetër këto standarde synojnë që jo vetëm të shërbejnë për shërbimet rezidenciale që ofrojnë mbështetje të specializuar të strehimit për komunitetin LGBTI+, por njëkohësisht që të japin një model se si shërbimet rezidenciale në tërësi të jenë më përfshirëse për komunitetin LGBTI+ (për shembull një gruaje lesbike mund t'i lindë nevoja të strehohet në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave dhe Dhunës në Familje). Kjo nënkupton që personeli i këtyre qendrave duhet të jetë i trajnuar dhe i aftë të kuptojë dhe të pranojë konceptet dhe parimet bazë të të punuarit me personat LGBTI+.

Strehëzat e grave dhe strehimi i grave transgjimore. Është e rëndësishme të theksohet veçanërisht vështirësia që mund të ndeshin shërbimet rezidenciale publike apo jopublike të disajnuara për gratë (strehëzat e grave), në strehimin e grave transgjimore, sidomos nëse nuk i janë nënshtruar operacionit të organeve gjenitale. Profesionalistët në këto strehëza mund të kenë frikë se një grua transgjimore (e cila nuk ka bërë operacion gjenital) mund të sulmojë seksualisht ose fizikisht një banorë tjetër. Ato mund të shqetësohen, gjithashtu, se ndoshta burrat që nuk janë transgjimorë mund të vishen si gra për të fituar pranimin në një strehë për gratë, në mënyrë që të sulmojnë gratë. Për dikë që ka pak përvojë me personat transgjimorë, këto shqetësime mund të duken shumë legjitime. Por, përvoja mbarëndërkombëtare tregon se gratë transgjimore (pavarësisht nëse e kanë kryer apo jo operacionin gjenital) nuk janë më të rrezikshme se sa gratë e tjera. Nuk është e drejtë apo e saktë të supozohet se vetëm sepse personi është transgjimor ose ka organe gjenitale mashkullore do të jetë kërcënim fizik për të tjerët. Çdo grua, transgjimore ose jo, mund të sulmojë një grua tjetër banorë në një strehë, në çdo kohë, për shkak të sëmundjes mendore ose një konflikti ndërpersonal etj. Stereotipat e personave transgjimorë që sulmojnë gratë vijnë nga filma dhe shfaqje televizive që portretizojnë në mënyrë të pasaktë personat transgjimorë si të rrezikshëm dhe abuzivë. Kjo është

larg së vërtetës. Kur bëhet fjalë për personat transgjimorë, rreziku më serioz është dhuna që do të ushtrohet ndaj tyre nga të tjerët. Gjithashtu, strehëzat duhet të mësojnë se është një mit që hapësira vetëm për gratë është gjithmonë e sigurt. Shqetësimi që mund të ndodhë abuzim i një gruaje nga një grua është i drejtë dhe përfshin situata, si mes grave me orientim seksual dhe identitet gjinor në përputhje me seksin e tyre të caktuar që në lindje, ashtu edhe mes grave lesbike e transgjimore. Prandaj për të shmangur abuzime të tilla, strehëzat duhet të kenë të vendosura rregulla të qarta, zbatimi i të cilave nga të gjitha banoret, transgjimore dhe jotransgjimore, mundëson mbajtjen e këtyre hapësirave të sigurta⁴.

Praktika premtuese

Eksperienca botërore ka identifikuar disa çështje të ndërthurura, të cilat nëse mbahen në konsideratë ndikojnë në kthimin e një shërbimi rezidencial në shërbim kulturor të aftë edhe për të dhënë shërbime për personat LGBTI+.

Krijoni një hapësirë ku personat LGBTI+ mund të jenë vetvetja. Shumë persona LGBTI+ (sidomos të reja e të rinj) vijnë nga komunitete që nuk e pranojnë plotësisht orientimin seksual apo identitetin dhe shprehjen gjinore të tyre. Ata mund të kenë përjetuar refuzim nga familja, miqtë/mikeshat, komunitetet dhe koleget/kolegët për t'u shprehur se cilët janë në të vërtetë. Prandaj është e rëndësishme që në shërbimet rezidenciale, të dedikuara ose jo vetëm për komunitetin LGBTI+, të punohet me përkushtim dhe të ofrohen hapësira ku personat LGBTI+ të ndihen vetvetja pa frikë nga gjykimi, paragjykimi apo dhe dhuna e ushtruar për këtë shkak. Mjedisë të tilla mund të arrihen përmes punësimit të profesionalistëve dhe profesionalistëve me mendje të hapur dhe trajnimit të vazhdueshëm të tyre për të qenë të përgatitur për të adresuar në mënyrë e duhur çështjet e personave LGBTI+, përfshirë dhe nevojën e tyre për shërbime mbështetëse të specializuara si strehimi.

Kthejini hapësirat në tërheqëse dhe angazhuese. Krijimi i një atmosfere qetësuese dhe të gëzueshme ndihmon shumë në angazhimin dhe mbështetjen e personave LGBTI+.

⁴ Për më shumë informacion dhe detaje referohuni tek:

<https://srp.org/wp-content/uploads/2012/08/TransitioningOurShelters.pdf>



Siguroni shërbimet e domosdoshme.

Pavarësisht nëse është një shërbim rezidencial publik apo jopublik, së bashku me strehimin duhet të ofrohen edhe shërbime të tjera thelbësore, të nevojshme për ruajtjen e shëndetit, dinjitetit dhe vetëvlerësimit (ushqim, veshje, kujdes mjekësor, mbështetje emocionale dhe këshillim/terapi, informacion dhe njohuri mbi legjislacionin, të drejtat, punësimin, ndjekje e rasteve në gjykatë etj.)

Përfshini vetë personat LGBTI+ në vendimmarrje dhe në disenjimin e shërbimeve.

Personat LGBTI+ janë vetë ekspertë të eksperiencave dhe traumave apo përjetimeve të tyre ndër vite dhe mund të japin orientimin e duhur, në mënyrën se si shërbimet për ta mund të bëhen më shumë gjithëpërfshirëse dhe më pak diskriminuese. Kjo nënkupton që sa herë të jepet mundësia të shtohet në organet vendimmarrëse për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve për këtë komunitet edhe anëtarësi nga vetë personat LGBTI+.

Investoni vazhdimisht për përmirësimin e kapaciteteve të stafit të qendrave rezidenciale.

Pavarësisht investimit që mund të bëni në momentin e pranimit në punë të një punonjëseje/punonjësi është e domosdoshme që të krijohet dhe të zbatohet një plan vjetor trajnimesh me tematika të caktuara të fokusuara tek ofrimi i shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për personat LGBTI+. Kjo pasi, siç u theksua edhe më sipër në këtë dokument, si kuadri ligjor për shërbimet dhe standardet e ofrimit të tyre, ashtu edhe gjuha dhe përkufizimet në lidhje me komunitetin LGBTI+ janë në përmirësim të vazhdueshme. Po kështu, nga monitorimi i vazhdueshëm i mënyrës së ofrimit të shërbimeve në qendrat rezidenciale, evidentohen edhe aspekte të nevojshme për përmirësim, të cilat duhet të adresohen bashkërisht. Prandaj aktivitetet e vazhdueshme në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve, do të ishin shumë ndihmuese për ofrimin e shërbimeve efektive, cilësore dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare e kombëtare.

Siguroni kujdes përmes shërbimeve të informuara për traumën.

Për shkak të ngjarjeve traumatike të përjetuara, personat LGBTI+ ndihen më të pranuar dhe trajtohen më efektivisht përmes shërbimeve të informuara mbi traumën. Kjo nënkupton që personeli është i trajnuar për të kuptuar ndikimin e traumës në të gjitha aspektet e

shëndetit dhe të sjelljeve, një shenjat e traumës të klientët, ndihmon me shërimin nga trauma dhe i reziston rriturizimit. Përveç kësaj, programet e sjelljes mund të ofrojnë mbështetje individuale dhe në grup për përballimin e traumës.

VI. STANDARDET PËR SHËRBIMIN E STREHIMIT PËR LGBTI+

STANDARDI 1

QËLLIMI DHE LLOJET E SHËRBIMEVE

Ofruesi i shërbimit zotëron një deklaratë ku shprehet qartësisht misioni, grupi i synuar dhe tërësia e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, që shoqërojnë ofrimin e shërbimit mbështetës të specializuar të strehimit, duke pasqyruar edhe kapacitetin për t'i vënë në zbatim shërbimet e deklaruara, me stafin dhe infrastrukturën e nevojshme.

Shërbimi mbështetës i specializuar i strehimit ka për qëllim të sigurojë një vend të sigurt për akomodim në një mjedis të përshtatshëm fizik dhe psikoshoqëror. Ai përfshin qasje falas në burimet e zgjedhura, të cilat janë të domosdoshme për mirëmbajtjen dhe promovimin e mirëqenies fizike, mendore dhe sociale të grupit të synuar të përfituesve. Është shumë e rëndësishme të mbahet në konsideratë fakti që personat e dhunuar LGBTI+ mbërrijnë në strehë pas një privimi të gjatë të të drejtave themelore të njeriut për strehim, siguri, dinjitet dhe identitet personal. Rrjedhimisht, kushtet e përshtatshme mjedisore paraqesin një nga mjetet më të fuqishme në kujdesin shëndetësor fizik dhe mendor, si dhe rehabilitimin psikosocial të tyre. Kjo vlen edhe për rastet kur përfituesit nuk kërkojnë shërbime specifike të kujdesit për shëndetin mendor.

Rezultati i dëshiruar: Të rejtat/rinjte LGBTI+ të dhunuar janë të mirëinformuar nga ofruesi i shërbimit mbi atë se çfarë mund të presin nga shërbimi, se si do të përkujdesen ndaj tyre dhe se cila/cili do të jetë profesionistja/profesionisti përgjegjës për përkujdesje. Një deklaratë e qartë mbi atë se si vepron ky shërbim, është e disponueshme për përfitueset/përfituesit dhe të interesuarit e tjerë.

Përfituesit e synuar

Strehëza është krijuar për të siguruar strehim të sigurt për të rejtat/rinjte LGBTI+, të cilat/cilët



kanë qenë viktime të dhunës⁵ për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor, shprehjes gjinore apo karakteristikave seksuale të tyre. Qëllimi është të sigurohet strehim i përshtatshëm dhe sipas standardeve për viktimat e dhunës, bazuar në kritere të përcaktuara nga ofruesit e shërbimeve për të rinjtë LGBTI+, të përshtatura dhe ndërtuara në përputhje me nevojat dhe diversitetin e këtyre personave.

Kriteret e përmbushjes së standardit	Prova që tregojnë përmbushjen e kriterit (treguesi i cilësisë)	Udhëzimet
Strehëza zotëron një deklaratë të qartë të misionit dhe të qëllimit të shërbimeve, ku shërbimet që ajo ofron janë lehtësisht të dukshme, të qarta dhe të aksesueshme për të gjithë personat LGBTI+ dhe të interesuarit e tjerë.	- Ka një dokument zyrtar që lidhet me deklaratën e qëllimit të formuluar sipas kriterëve të përmbushjes së standardit. - Personeli i qendrës zbaton me rigorozitet politikën përkatëse, të përshkruar në deklaratën e qëllimit.	Duke qenë se të rejtat/rinjtë LGBTI+ të vendosur në strehimore kanë nevojë për informacion të detajuar mbi shërbimet që do të marrin dhe procedurat që do të ndiqen për mbrojtjen e tyre, deklarata e qëllimit formulohet me një gjuhë sa më të qartë e të kuptueshme për nivele të ndryshme arsimore dhe personeli bën shpjegimin e saj me kujdes për cilindo përfitues shërbimi të sapopranuar.
Të rinjtë LGBTI+ dhe ofruesit e shërbimeve kanë akses te deklarata e qëllimit, misioni dhe rregullorja e strehëzës dhe kuptojnë në mënyrë të qartë shërbimet.	- Kopje të deklaratës së qëllimit janë të dukshme në të gjitha ambientet e strehëzës dhe janë të disponueshme për përdoruesit, si dhe në forma lehtësisht të kuptueshme nga të gjithë. Sugjerohet që deklarata e qëllimit të jetë e shkruar edhe në alfabetin <i>Braille</i> ose e regjistruar me mjetet audiovizive të përshtatshme për përdorim nga personat LGBTI+ me aftësi të kufizuara.	Duke qenë se ky shërbim i shërben të rinjve deklarata e qëllimit dhe përshkrimi i shërbimeve duhet të përshtatet me të kuptuarin e kategorive brenda kësaj grup-moshe, si edhe për të rejtat/rinjtë LGBTI+ me aftësi të kufizuara, nga minoritete etnike të ndryshme etj.
Stafi ofron menjëherë dhe vazhdimisht informacion lidhur me funksionimin e strehëzës dhe shërbimeve që do t'u ofrohen të rejtave/rinjtë LGBTI+.	- Ka një rregullore të brendshme dhe një manual të funksionimit të qendrës, ku përcaktohen qartë deklarata e qëllimit dhe mënyrat e marrjes së njohurive rreth përmbajtjes së saj. - Stafi ka marrë dijeni për Politikën e Mbrojtjes së të Rriturve Vulnerabël dhe e ka firmosur (përfshin stafin e kontraktuar, apo profesioniste/profesionistë të tjera/ë që do të kenë kontakt me të rejtat/rinjtë LGBTI+).	Dokumente të cilat shërbejnë për të informuar përfitueset/përfituesit mund të jenë: fletëpalosje, broshura etj. Përmbajtja e tyre duhet të përfshijë detaje mbi të dhënat e ofruesit të shërbimeve, misionin, qëllimin, llojet e shërbimeve të kujdesit shoqëror të disponueshme për të rejtat/rinjtë LGBTI+, përshkrimin e parimeve bazë të ofrimit të shërbimeve, si konfidencialiteti, siguria dhe mbrojtja etj.
Deklarata e qëllimit rishikohet dhe përmirësohet në mënyrë periodike dhe pas kësaj vijojnë modifikimet përkatëse në dokumentet dhe praktikatat e tjera.	- Dokumentet dhe aktet zyrtare tregojnë që deklarata e qëllimit është diskutuar dhe rishikuar rregullisht.	Bordi drejtues i qendrës merr në shqyrtim dhe miraton periodikisht deklaratën e përmirësuar të qëllimit të funksionimit të shërbimit të strehimit dhe për këtë ekzistojnë dhe vendimet përkatëse të firmosura.

⁵ Referohuni përkufizimit të dhunës së pësuar nga personat LGBTI+ në fillim të dokumentit.



Llojet e shërbimeve. Strehëza merr masa që përfituesja/përfituesi të informohet, të zgjedhë dhe të përfitojë sipas nevojës një sërë shërbimesh të domosdoshme.	- Strehëza ofron një paketë të plotë dhe eficiente shërbimesh, në përputhje me nevojat komplekse të të rejave/rinjve LGBTI+, në bashkëpunim me ofruesit parësorë dhe alternativë të shërbimeve, për të mundësuar mbrojtje dhe strehim të sigurt.	Shërbimet e ofruara nga strehëza plotësojnë nevojat minimale individuale të cilitdo personi të marrë në mbrojtje, për shkak të rrezikut të deklaruar nga ai vetë apo të vërtetuar nga rrethanat, si urdhri i mbrojtjes, kërkesë-padia etj.
Shërbimet minimale të ofruara duhet të jenë: Strehimi (strehëza); Veshmbathja; Ushqimi; Referimet. Shërbime të tjera që mund të ofrohen, janë: Këshillim psikologjik individual dhe/ose në grup Psikoterapi, në rastet kur paraqitet e nevojshme një ndërhyrje më e thellë psikologjike. Kjo mund të ofrohet nga psikologu/psikologia e strehëzës, nëse ai/ajo ka formim psikoterapeutik ose mund të kontraktohen psikoterapistë të tjerë nga strehëza përkatëse. Shërbime mjekësore. Shërbime ligjore. Shërbime informimi dhe formimi profesional. Asistencë edukative/arsimore. Trajnim i aftësive jetësore. Mentorim Mentorim nga bashkëmoshatarë/anëtarë të komunitetit LGBTI+. Ndërmjetësim me familjen apo me anëtarë të caktuar të familjes, kur familja nuk është dhunuese apo e rrezikshme për mirëqenien e personit. Ndërmjetësimi për punë. Aktivitete sociale. Terapi okupacionale etj.	- Kontrata për shërbimet që do të ofrohen, e firmosur pasi të jetë lexuar dhe shpjeguar nga personeli dhe e futur në dosjen e përfitueses/përfituesit. - Kontratë për shërbimet e ofruara në rast se këto shërbime janë të kontraktuara jashtë strehëzës dhe janë specifike - Stafi ka njohuri dhe është i trajnuar për nevojat dhe ofrimin e shërbimeve afirmuese të të rejat/rinjve LGBTI+. - Kontrata për shërbimet në dosjen e përfitueses/përfituesit. Kontratë për shërbimet ose akt mirëkuptimi për referimet. Shërbimet janë të organizuara sipas kompetencës sektoriale të ofruesit të shërbimit, në raport me nevojat e grupit të përfituesve.	Ekzistojnë udhëzime të qarta të shkruara mbi mënyrën e ofrimit të çdo shërbimi, duke filluar nga cilësia e ushqimit, menuja ditore, hapësira e akomodimit, higjiena, kushtet e përshtatshme për të siguruar ambiente privatësie etj. Strehëza nuk duhet të ofrojë, në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin objekt, dy lloje kujdesi që bien ndesh me interesin më të lartë të përfituesve, përdorimin e stafit ose përdorimin e qendrës. Shërbimi duhet të dokumentojë se nuk ka një konflikt të tillë. Punonjësja/punonjësi përgjegjës siguron që çdo shërbim i ofruar është në përputhje me nevojën e përfituesve. Çdo shërbim i ofruar regjistrohet në ditarin ditor ose në dosjen personale të përfituesve, sipas formës përkatëse. Çdo shërbim është i shoqëruar me aneksin shpjegues përkatës. Secila/secili profesioniste/profesionist dokumenton shërbimet e veta, nëpërmjet formave të përcaktuara të vlerësimit, planifikimit të ndërhyrjeve, aplikimit të terapive etj.
Përfitueset/përfituesit e strehës duhet të marrin pjesë aktivisht në administrimin e programit, duke u kujdesur për nevojat e tyre, pra duke qenë përgjegjës për hapësirën e tyre gatimin, pastrimin, kujdesin personal etj., personalisht ose në grup me përfitueset/përfituesit e tjerë. Përfituesja/përfituesi duhet të ketë nën kontroll mjetet e veta monetare. Përfitueset/përfituesit të angazhohen në mirëmbajtjen e mjediseve personale dhe të përbashkëta.	Dokumente ku përcaktohen detyrat e qarta të përfituesve të strehëzës, në lidhje me mirëmbajtjen e mjediseve, plan javor mujor pune etj. Pjesët nga rregullorja që saktësojnë mënyrën e bashkëpunimit dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e mjediseve, realizimin e aktiviteteve të përbashkëta të kujdesit, administrimin e mjeteve personale monetare, përgjegjëshmërinë për ruajtjen dhe kujdesin për ambientet dhe pajisjet apo materialet e strehëzës etj., të jenë të afishuara dukshëm në mjediset e strehëzës, të shkruara me gjuhë të qartë, të kuptueshme për të gjithë personat LGBTI+, përfshirë dhe ata me aftësi të kufizuara.	Kontratë e nënshkruar në dosjen e përfituesve të strehës. Plani i ndihmës i përgatitur në bashkëpunim me personin që përfiton shërbimin e strehimit dhe i futur në dosjen personale.



STANDARDI 2

VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE PLANI I PËRKUJDESJES PËR PËRFITUESIT E STREHËS

Rezultati përfundimtar i dëshiruar:

Nevojat emergjente dhe afatgjata të të rejave/rinjve LGBTI+, përfituese/përfitues të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore të ofruar në strehëz, të vlerësuara në mënyrë të plotë dhe efektive, duke respektuar dinjitetin e tyre, si dhe planet individuale të përkujdesjes të hartuara në bazë të këtyre nevojave.

Standardi

Ekipi multidisciplinar i strehës harton planin e përkujdesjes në bashkëpunim me secilën/secilin përfituese/përfitues. Ky plan paraqet në mënyrë të dukshme nevojat e vlerësuara të përfitueses/përfituesit dhe veprimet e duhura për të zgjidhur ose përmbushur këto nevoja.

Kriteret e përmbushjes së standardit	Prova që tregojnë përmbushjen e kriterit (treguesi i cilësisë)	Udhëzime
Strehëza është përgjegjëse për të organizuar një ekip multidisciplinar profesionistesh e profesionistësh ku përfshihen minimalisht, por nuk kufizohet: punonjësja/punonjësi social, psikologja/psikologu, punonjësja/punonjësi i rastit. Profesioniste/profesionistë të tjerë të cilat/cilët marrin pjesë në planin e ndihmës, mund të jenë mjekja/mjeku, juristja/juristi, psikiatra/psikiatri etj. Strehëza është përgjegjëse për kryerjen e vlerësimit të nevojave të cilësdo/cilido përfitueseje/përfituesi brenda një afati kohor maksimal prej 3- javësh, nga momenti i akomodimit në qendër. Për rastet kur vlerësimi kërkohet me urgjencë, vendoset të bëhet menjëherë. Monitorimi i procesit të vlerësimit siguron se vlerësimi është bazuar në rregulloret dhe në standardet e miratuara.	Drejtuësja/drejtuësi i shërbimeve, përgjegjëse/përgjegjës për kujdesin dhe mbrojtjen e të rejave/rinjve LGBTI+ organizon një ekip, Multidisciplinar profesionistesh/profesionistësh. Ekipi zhvillon një plan për vlerësimin e të gjitha nevojave të përfitueses/përfituesit. Që në fillim vendoset një datë për plotësimin e raportit të vlerësimit. Plani i ndërhyrjes i përfitueses/përfituesit ndërtohet brenda 3 javëve kalendarike, nga momenti kur përfituesja/përfituesi futet në shërbim. Ka formate të përcaktuara vlerësimi, të cilat janë të përshtatura sipas nevojave të personave LGBTI+. Pasi bëhet vlerësimi, përfitueses/përfituesit i vihet në dispozicion një dokument i shkruar vlerësimi që ka të bëjë me nevojat e saj/tij të përcaktuara nga përfituesin në bashkëpunim me grupin shumëdisiplinar, me qëllim që përfituesja/përfituesi të informohet në mënyrë të përshtatshme për gjendjen e saj/tij psikoemocionale dhe për nevojat e identifikuara, si dhe që procesi i vlerësimit nuk ka cenuar dinjitetin e përfitueses/përfituesit.	Punonjësja/punonjësi i rastit është përgjegjëse/përgjegjës për të bërë një vlerësim të plotë për përfituesen/përfituesin e strehëzes, në lidhje me rastin e saj/tij. Këtë vlerësim ofruesi i shërbimit ua vë në dispozicion ofruesve alternativë të shërbimeve, të cilët përcaktojnë shërbimet e përshtatshme që ata mund të ofrojnë për çdo rast. Formatet duhet të përmbajnë këshilla për punën me të rejat/rinjët LGBTI+, si dhe vendosjen e një marrëdhënieje dypalëshe. Në këtë format përfshihen pyetje të hapura dhe mënyra se si të krijohet një klimë e hapur e ngrohtë dhe afirmuese komunikimi, ku profesionistët/profesionistët të cilat/cilët intervistojnë përfituesen/përfituesin janë të njohur me termat e lidhur me orientimin seksual, identitetin gjinor, shprehjen gjinore dhe karakteristikat seksuale dhe forma e intervistimit është në përputhje me parimet e dhënies së shërbimeve afirmuese për personat LGBTI+. Punonjësja/punonjësi i rastit duhet të fokusohet në pyetje që kanë të bëjnë me ndihmën ndaj përfitueses/përfituesit. Formatet duhet të përcaktojnë ndryshimet midis informacionit personal të nevojshëm për të vlerësuar nevojat personale të përfitueses/përfituesit nga eksperiencia personale dhe të dhënat paraprake.



- Punonjësja/punonjësi i rastit duhet të planifikojë planin e përkujdesjes individuale të përfitueses/përfituesit, bazuar mbi vlerësimin e nevojave të saj/tij. Procesi i realizimit të planit bëhet në bashkëpunim të ngushtë dhe i udhëhequr nga nevojat e përfituesit/përfitueses.	Plani individual i përkujdesjes, i hartuar dhe miratuar edhe nga vetë përfituesja/përfituesi, bazuar në nevojat e saj/tij dhe i futur në dosjen personale.	- Lidhja e masave të planifikuara në planin e përkujdesjes, me nevojat e përfituesit/përfitues (emergjente dhe afatgjata) është domosdoshmëri. Gjatë hartimit të këtij plani duhet të merren në konsideratë informacione që vijnë nga institucione të tjera, të tilla si: shkolla, të afërm, qendra shëndetësore, ofrues të tjerë shërbimesh, njësitë e vetëqeverisjes vendore etj.
Përfitueset/përfituesit e shërbimeve të strehëzës përfshihen në mënyrë aktive në kryerjen e vlerësimit dhe hartimin e planit individual të trajtimit. Punonjësi/punonjësja e rastit çon përpara procesin e hartimit të planit në bashkëpunim të ngushtë dhe i/e udhëhequr nga nevojat e përfituesit dhe monitoron ecurinë e zbatimit të tij. Plani, i cili duhet të jetë në formë të shkruar, realist dhe i arritshëm, duhet të miratohet edhe nga menaxherja/menaxheri i shërbimit i të strehëzës dhe nga përfituesja/përfituesi i shërbimeve.	Përfitueset/përfituesit e shërbimeve të strehëzës janë në gjendje të konfirmojnë përfshirjen e tyre në hartimin e dokumentit të vlerësimit dhe të planit të tyre individual të ndihmës. Përfshirja e tyre në hartimin e këtyre dokumenteve konfirmohet nga materialet e shkruara. Një kopje e planit i jepet secilës/secilit përfitues/përfituesi dhe vendoset në dosjen e saj/tij individuale. Dosjet e përfituesve të strehëzës mbahen në një vend të sigurt dhe administrohen vetëm nga punonjësja/punonjësi i rastit. Çdo dosje e përfituesve duhet të ketë një kopje të përcaktimit të nivelit të rrezikut dhe dokumentacionin mbi masat e marra për mbrojtje kundër kërcënimeve të identifikuara. Ofruesi i shërbimeve duhet të vendosë nëse situata e sigurisë së përfituesve i lejon ata të marrin pjesë në programin e tyre dhe të qëndrojnë në qendrën e tyre, bazuar në nivelin e sigurisë që mund të ofrojë strehëza.	Plani përfshin objektivat, mjetet dhe mënyrat për t'i arritur ato, kush është përgjegjës për çdo veprim, datën e kryerjes së veprimit dhe datat e rishikimeve të bëra periodikisht. Konfirmimi për zbatimin me përpikëri të këtij kriteri dhe për saktësinë e treguesit duhet të kërkohet edhe nga anëtarët e stafit dhe/ose nga përfitueset/përfituesit, aty ku është e mundur. Ky konfirmim mund të kërkohet nga individë të përzgjedhur, të cilët janë pjesë të anëtarëve të stafit/të rejat/rinjtë LGBTI+ ose nga takimet në grup të organizuara për këtë qëllim.
Çdo përfitues/përfitues i strehëzës përfshihet në përcaktimin e aktiviteteve, të cilat janë më të përshtatshme për të.	Aktivitete të programuara brenda dhe jashtë rrejtit të bashkëpunimit vihen në dispozicion për të gjithë përfitueset/ përfituesit e strehëzës, edhe nëse ato nuk mund të ofrohen të gjitha nga ofruesi primar i shërbimit. Përfitueset/përfituesit e strehëzës bien dakord me planin e veprimit të përcaktuar nga ata vetë në bashkëpunim me ekipin shumëdisiplinar të profesionistëve/profesionistëve. Përfituesja/përfituesi i strehëzës në çdo kohë mund të informojë punonjësen/ punonjësin social që ai/ajo nuk është e/i gatshëm të vazhdojë me këtë plan dhe dëshiron që ky plan të rishikohet ose të ndërpritet.	Programi i ndihmës dhe të gjithë komponentët e tij përfshijnë: aktivitete sociale, edukuese, trajnime profesionale, rritje të aftësive jetësore, ndërmjetësim për punësim dhe aktivitete të tjera të fuqizimit ekonomik, ndërmjetësim me familjen kur kjo është e mundur etj. Përfituesve u shpjegohet rëndësia e këtyre disiplinave. Konfirmimi për zbatimin me përpikëri të këtij kriteri dhe për saktësinë e treguesit duhet të kërkohet edhe nga anëtarët e stafit dhe/ose aty ku është e mundur edhe nga të rejat/rinjtë LGBTI+. Ky konfirmim mund të kërkohet nga individë të përzgjedhur, që janë pjesë e stafit. Përfituesit e shërbimeve të strehëzës ose nga takimet në grup të organizuara për këtë qëllim.



STANDARDI 3

MJEDISI DHE KUSHTET PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE

Rezultati përfundimtar i dëshiruar

Përfituesja/përfituesi i shërbimeve përfiton shërbime në kushte dhe në një mjedis të përshtatshëm.

Standardi

Strehëza siguron kushte dhe mjedis të përshtatshëm për përfitueset/përfituesit dhe për stafin, në përputhje me kapacitetin, karakterin e shërbimeve dhe nevojat e përfituesve.

Kriteri e përmbushjes së standardit	Prova që tregojnë përmbushjen e kriterit (treguesi i cilësisë)	Udhëzime
Strehëza ofron një mjedis, i cili është i mobiluar dhe i sistemuar për të krijuar një ambient të këndshëm dhe të përshtatshëm për përfitueset/përfituesit, sipas moshës dhe interesave të saj/tij dhe që respekton të drejtën e saj/tij për privatësi.	Mjedisi i brendshëm i strehëzës i mirorganizuar, me ndarje të qarta të ambienteve të përshtatura dhe mobiluara për të krijuar një mjedis pritës të ngrohtë e miqësor. Ambiente ndihmëse private (tualet, dushe etj.), të cilat ndihmojnë në krijimin e sigurisë dhe të vetëbesimit gjatë qëndrimit në qendër të përfituesve/përfituesve të shërbimit.	Strehëza përcakton paraprakisht se çfarë dëshiron t'u ofrojë përfituesve. Aktivitetet dhe lloji i shërbimeve përcaktojnë çfarë hapësirash dhe pajisjesh, shtesë kërkohen në mënyrë që përfituesja/ përfituesi të ndihet mirë. Një inventar i pajisjeve dhe i mjeteve në dispozicion i afishuar dukshëm në ambientet e strehëzës.
Strehëza ofron ambiente të sigurta dhe të monitoruara. Ofruesi i shërbimeve duhet të ndërmarrë një vlerësim të plotë dhe profesional të sigurisë për godinën ku do të strehohen përfitueset/përfituesit.	Vlerësimi duhet të deklarojë qartë të gjitha masat e sigurisë që duhet të vendosen. Çdo ambient në strehë duhet të jetë i pajisur me masat kundër zjarrit dhe vetë strehëza të ketë një dalje emergjente dytësore. Procedurat e evakuimit të menjëhershëm në rast zjarri ose arsye tjetër për evakuim të godinës, duhet të jenë me shkrim dhe të afishuara në strehë. Ofruesi i shërbimeve duhet të kenë një plan se ku do të dërgohen përfitueset/përfituesit në rast të evakuimit të qendrës. Për këtë qëllim, këshillohet përdorimi i rrjetit të shërbimeve të tjera.	Raporti final nga vlerësimi i sigurisë duhet të ruhet në dosjet e ofruesit të shërbimeve. Vlerësimi i sigurisë së godinës duhet të përditësohet rregullisht. Niveli i sigurisë duhet të rivlerësohet minimalisht çdo vit. Duhet që të afishohen informacionet e kontaktit në strehë për policinë, urgjencën, spitalin, zjarrfikësit dhe kontakte të tjera të emergjencës.
Strehëza krijon kushte të përshtatshme për përfitueset/përfituesit, në bazë të nevojave të tyre specifike (p.sh., nevoja për arsimim), për përfitueset/përfituesit me aftësi të kufizuara (AK), për përfitueset/përfituesit alergjikë ndaj ushqimeve, për besimtarë të besimeve të ndryshme etj.	Çdo përfituese/përfitues përmbush nevojat e saj/tij: - klasa, libra, programe edukative; - ambiente fizike për të mundësuar aksesueshmërinë për përfitueset/përfituesit me AK (tualet, dushe, rampa etj.); - dieta specifike për përfitueset/përfituesit alergjike/ë ndaj ushqimeve; - hapësira të veçanta ku mund të ushtrohen ritet fetare.	Në ambientet e qendrës afishohen dukshëm informacione dhe orientime për drejtëtimet për të shkuar në secilin prej ambienteve. Secili ambient i identifikuar me një tabelë të dukshme dhe me efekt ndriçues për të lëvizur lirshëmrisht edhe gjatë natës apo për të krijuar lehtësi për personat me AK.
Ambientet e përbashkëta duhet të kenë të gjitha materialet e nevojshme për jetesë kolektive. Në një dhomë gjumi nuk mund të flenë më shumë se 3–4 përfituese/përfitues, por merren masa për të siguruar hapësira për funksionim normal të përfitueses/përfituesit.	Një dhomë gjumi ka krevat, komodinë, dollap rrobash, ndriçim të mirë, ngrohje dhe ftohje, çarçafë dhe mbulesa të ngrohta (batanije, jorgan etj.) etj.	Inventari i pajisjeve të dhomës së gjumit i afishuar prapa derës së secilës dhomë.
Ka rregulla të brendshme për përdorimin dhe funksionimin e ambienteve të institucionit.	Rregullore të shkruara për përdorimin e ambienteve private, të përbashkëta, të zyrave të profesionistëve/profesionistëve etj.	Ambientet e përbashkëta monitorohen nga kamera ose stafi i turnit gjatë zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta.



Strehëza siguron një ambient të përshtatshëm dhe pajisje të nevojshme për stafin për të kryer punën në standarde të kënaqshme.	Zyra e stafit ka të gjitha pajisjet e nevojshme (tavolinë, kompjuter, karrige, dollap, kasafortë, telefon etj.). Dhomat e profesionisteve/profesionistëve sigurojnë komoditetin, privatësinë dhe konfidencialitetin e përfutuesit/përfutueses.	Shërbimet e ofruara nga profesionistët/profesionistët sigurojnë privatësi dhe konfidencialitet për përfutueset/përfutuesit.
Përfutueset/përfutuesit aktivizohen për mirëmbajtjen e ambienteve personale dhe të përbashkëta, kjo jo vetëm në kontekstin e mirëmbajtjes së ambienteve të përbashkëta, por njëkohësisht edhe për rritjen dhe zhvillimin e aftësive jetësore të përfutuesve.	Dokumente që përcaktojnë detyra të qarta të përdoruesve dhe të përbashkëta për mirëmbajtjen e ambienteve, grafikët javorë/mujorë të punës etj.	Udhëzimet për mirëmbajtjen e ambienteve, grafikët javorë dhe mujorë të punës të afishuar dukshëm në ambientet e qendrës.

STANDARDI 4

STREHËZA OFRON SHËRBIME AFIRMUESE PËR TË RINJTË LGBTI+

Rezultati përfundimtar i dëshiruar:

Personat e komunitetit LGBTI+ gjejnë një hapësirë të sigurt dhe një ambient ku identiteti i tyre gjinor, orientimi seksual dhe karakteristikat seksuale respektohen dhe promovohen.

Standardi:

Ekipi multidisiplinar i strehëzës është në gjendje që të ofrojë shërbime afirmuese ku aspekte të orientimit seksual, identitetit gjinor, shprehjes gjinore dhe karakteristikave seksuale njihen, pranohen, perceptohen pozitivisht dhe promovohen nga stafi i institucionit.

Kriteret e përmbushjes së standardit	Prova që tregojnë përmbushjen e kriterit (treguesi i cilësisë)	Udhëzime
Ofruesi i shërbimeve përcakton në dokumentet thelbësore të tij shërbimet afirmuese, si filozofi kryesore e dhënies së shërbimeve, duke e cilësuar afirmimin si një parim bazë të punës.	Ofrimi i shërbimeve afirmuese për personat LGBTI+ është pjesë e dokumenteve thelbësore të organizatës, përfshirë statutin, planin strategjik etj.	Është e rëndësishme që konceptet të rifreskohen herë pas here dhe në dokumentet strategjike të përfshihen, gjithashtu, risitë e lidhura me terminologjinë apo me çdo aspekt tjetër.
Strehëza trajnon punonjëset/punonjësit e rinj mbi aspekte të rëndësishme të lidhura me SOGIESC-n dhe me ofrimin e shërbimeve afirmuese.	Të gjithë punonjëset/punonjësit e strehëzës janë të trajnuar mbi çështje të SOGIESC dhe ofrimin e shërbimeve afirmuese për personat LGBTI+.	Plani i trajnimeve dhe mentorimit të punonjëseve/punonjësve të qendrës, i përgatitur dhe rifreskuar vazhdimisht.
Ekziston një format i veçantë i vlerësimit ku pasqyrohen çështjet e rëndësishme të lidhura me SOGIESC dhe një fushë përkatëse e planit të ndihmës që shërben për të adresuar çështjet e ngritura në planin e ndihmës.	Formati përkatës që vlerëson aspekte të SOGIESC të përfutueses/përfutuesit është në dosje.	Ekzistojnë publikime (manuale, broshura etj.) me listën e përkufizimeve dhe të koncepteve kryesore të lidhura me SOGIESC, të përditësuara, në dispozicion të stafit.
Në të gjitha formatet e vlerësimit merren parasysh çështje të lidhura me SOGIESC, përfshirë formatin e vlerësimit të marrëdhënieve familjare, vlerësimin e nevojave profesionale etj.	Formatet e vlerësimit kanë të përfshirë elementë të impaktit të SOGIESC të përfutueses/përfutuesit në fushat përkatëse që vlerësohen.	Stafi është i trajnuar që të shikojë të gjitha fushat e vlerësimit nën fokusin e çështjeve të lidhura me orientimin seksual, identitetin gjinor dhe shprehjen seksuale, si për shembull, vlerësimin e sigurisë, vlerësimin e marrëdhënieve familjare, vlerësimin e nevojave profesionale etj.



Ofruesi i shërbimit monitoron në vazhdimësi nëse ofrimi i shërbimeve përputhet me filozofinë thelbësore të shërbimeve afirmuese.	- Pyetësorë të plotësuar nga përfituesit dhe të zhvilluar në anonimat të plotë mbi ofrimin e shërbimeve në mënyrë afirmuese nga stafi i strehëzës - Raport vjetor i ofruesit të shërbimit për monitorimin e shërbimit pers a i përket përputhshmërisë së zbatimit të parimeve të shërbimeve afirmuese	- Gjetjet e raportit ndahen me stafin e shërbimit rezidencial dhe me institucionin më të lartë qeverisës të strehëzës. Sugjerohet që pyetësorët dhe raporti të shërbejnë si bazë për të përmirësuar dhënien e shërbimeve afirmuese.
--	--	--

STANDARDI 5

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PËRFITUESVE

Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Përfitueset/përfituesit e shërbimit në qendër gëzojnë të gjitha të drejtat e parashikuara në ligj, trajtohen me dinjitet e respekt, si dhe mbrohen nga të gjitha format e abuzimit dhe diskriminimit gjatë kohës së qëndrimit në strehë.

Standardi: Strehëza ofron shërbime për përfitueset/përfituesit të bazuar në parimet e respektit dhe afirmimit dhe pa diskriminuar, për shkak orientimit seksual, identitetit gjinor, shprehjes gjinore, karakteristikave seksuale, të racës, ngjyrës, kombësisë, gjuhës, gjinisë, bindjeve politike, fetare apo filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore apo shoqërore, shtatzënisë, të qenët prind, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozitave gjenetike, aftësive të kufizuara, përkatësisë në një grup të caktuar apo për çfarëdo arsyes të tjera.

Kriteret e përmbushjes së standardit	Prova që tregojnë përmbushjen e kriterit (treguesi i cilësisë)	Udhëzime
Ofruesi i shërbimit ofron informacion të vazhdueshëm mbi të drejtat e përfituesve, me qëllim që ata t'i njohin ato dhe të dinë mekanizmat e ankesës kur këto të drejta shkelen.	Broshurë/fletëpalosje/dokument i afishuar që përfshin të drejtat dhe detyrimet gjatë kohës së qëndrimit në strehë, përfshirë të drejtën e përfitimit të shërbimeve pa diskriminim. Ofruesi i shërbimit afishon forma të shkruara të të drejtave të përfituesve të shërbimeve, dhe sigurohet që nëpërmjet diskutimeve përfitueset/përfituesit i kuptojnë dhe i gëzojnë të drejtat e tyre.	Materialet me informacion mbi të drejtat, të afishuara dukshëm në qendër dhe të përgatitura me një gjuhë të kuptueshme për të gjithë të rejt/rinjtë LGBTI+, përfshirë dhe ata me AK.
Ka një procedurë ankimi të qartë për trajtimin e ankesave, që është e hapur për të gjithë, përfitueset/ përfituesit dhe stafin. Procedura përmban afatet e përgjigjes dhe organet/personat që trajtojnë ankesën.	Ka një dokument të qartë që sqaron procedurat e ankimeve në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Kjo, përfshin: kush mund të bëjë ankesë dhe ku, afatin përfundimtar për një përgjigje dhe organet/personat që do të trajtojnë ankesat etj., e miratuar nga bordi dhe e njohur nga të gjithë përfitueset/përfituesit dhe stafi. Mbajtja e dosjeve të veçanta për ankesat e marra, për detajet e investigimeve, masat e ndërmarra dhe për rezultatet e ankesave.	- Duhet të mbahet një bazë të dhënash më vete për të gjitha ankesat e depozituara dhe për zgjidhjen që u është dhënë. - Përfituesi/përfituesja ka të drejtë të bëjë ankesë, në lidhje me mënyrën e trajtimit dhe të kujdesit që i ofrohet nga stafi dhe mjete të tjera të vëna në dispozicion për të. - Anëtarët e stafit kanë të drejtë të bëjnë ankesë, në lidhje me mënyrën e trajtimit nga drejtueset/drejtuesit dhe nga anëtarët e tjerë të stafit.
Stafi respekton dhe promovon të drejtat e përfituesve të shërbimit, si dhe i trajton ata me respekt dhe dinjitet të bazuar në parimet e interesit më të lartë të përfituesit/përfitueses dhe të fuqizimit. Këto të drejta bazohen në legjislacionin shqiptar dhe konventat për të drejtat e	Të gjithë të drejtat e përfituesve janë të dokumentuara. Një kopje e tyre u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të stafit, si dhe vetë përfituesve. Të drejtat janë paraqitur, gjithashtu, në udhëzuesin e shërbimit. Konsultimi me përfituese/përfitues dhe/ose anëtarë të stafit	- Këto rregulla janë të detyrueshme për të gjithë përfitueset/përfituesit. - Ofruesi i shërbimeve duhet të monitorojë dhe të supervizojë zbatimin e tyre.



njeriut të ratifikuar nga shteti shqiptar. Këto të drejta janë të shprehura qartë në çdo rregullore, procedurë pune dhe zbatim i tyre është i monitorueshëm.	është i rëndësishëm, me qëllim realizimin e vlerësimit nëse kriteri është përmbushur apo jo.	
Përfutjesja/përfutjesi të trajtohet si pjesëmarrëse/pjesëmarrës në program dhe vihet theksi te pikat e forta dhe fuqizimi i përfutjesve.	Dokumentet në dosjen e rastit, ku tregohet pjesëmarrja aktive në hartimin dhe zbatimin e planit individual të ndërhyrjes.	Pjesëmarrja e përfutjesve është thelbësore për të shkuar drejt pavarësisë dhe fuqizimit të tij/saj.

STANDARDI 6

STAFI, PERFORMANCA DHE ZHVILLIMI I TIJ

Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Strehëza garanton shërbime profesionale nëpërmjet përzgjedhjes së kujdesshme të të gjithë stafit dhe marrjes së masave për mbrojtjen dhe zhvillimin profesional të tyre.

Standardi: Struktura, numri i punonjësve/punonjësve, arsimimi dhe aftësitë e tyre janë të përshtatshme për plotësimin e nevojave të përfutjesve të shërbimit, gjë që bën të mundur ruajtjen e cilësisë dhe efektivitetit në shërbimet e ofruara. Institucioni siguron trajnime, ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve profesionale të stafit të tij si edhe kujdes ndaj konsumimit profesional.

Kriteret e përmbushjes së standardit	Prova që tregojnë përmbushjen e kriterit (treguesi i cilësisë)	Udhëzime
Ofruesi i shërbimit ka një strukturë të detajuar të stafit, e cila paraqet numrin e vendeve të punës, përshkrimet e punës, kualifikimet e kërkuara, dhe detyrat e përgjegjësitë të secilës/secilit profesioniste/profesionist.	Dokumente të regjistruara ku përfshihen: Dokumenti i politikave të stafit, struktura e stafit (organigrama), numri dhe pozicioni i anëtarëve të stafit, struktura menaxhuese, procedurat e përzgjedhjes dhe rekrutimit të stafit, përshkrimi i vendit të punës, kualifikimet e nevojshme, si edhe aftësitë specifike që duhet të ketë stafi dhe vullnetaret/vullnetarët në ofrimin e shërbimeve të caktuara për përfutjeset/përfutjesit.	I gjithë dokumentacioni duhet të jetë i hapur ndaj agjencive rregullatore dhe personave të cilët aplikojnë për një vend pune.
Struktura dhe numri i stafit, kualifikimet dhe eksperiencat e tij korrespondon me nevojat dhe shërbimet e përcaktuara nga ofruesi i shërbimit.	Organigrama e ofruesit të shërbimit. Dosjet specifike të stafit.	Përveç përshtatjes së shkollimit dhe kualifikimeve përkatëse, sugjerohet që stafi të ketë njohuri në dhënien e shërbimeve afirmuese dhe shërbimet e informuara për traumën. Nëse stafi nuk i ka këto njohuri atëherë sugjerohet që strehëza merr masa në ngritjen e kapaciteteve të stafit në këto dy elemente të rëndësishme të punës me personat LGBTI+.
Formimi i anëtarëve/anëtarëve të stafit përputhet me pozicionin e përcaktuar në strukturën e organigramës	Dosjet personale të anëtarëve/anëtarëve të stafit.	Kalendari i trajnimeve dhe i kualifikimeve të herëpashershme si dhe një bazë të dhënash me kualifikimet e plotësuar nga secila/secili punonjëse/punonjës.



Ka një procedurë të caktuar për rekrutimin e stafit. Stafi ka status social, ligjor dhe shëndetësor që nuk përbën rrezik për funksionimin e institucionit dhe mirëqenien e përfituesve, që vërtetohet nëpërmjet dokumentacionit përkatës.	Të gjitha dokumentet, duke përfshirë: referencat, formularët e aplikimit dhe shënimet e intervistës janë të evidentuara në dosjet personale të secilës/secilit anëtar të stafit, për shembull një dëshmi penaliteti.	Në procedurën e rekrutimit janë përcaktuar qartë komisioni, formularët e aplikimit, afatet përfundimtare për marrjen e vendimeve.
Stafi i rekrutuar duhet të ketë njohuritë e duhura të lidhura me rolin e tij dhe të institucionit në përgjithësi. Duhet të kenë njohuritë e duhura të lidhura me dhënien e shërbimeve për grupet e diskriminuara dhe njohuri të lidhura me shërbimet e informuara për traumën.	Stafi njeh mirë përshkrimet e punës, si dhe kupton se përgjegjësitë që ka kontribuojnë për mirëqenien e përgjithshme të përfituesve.	Rregullore e brendshme e ofruesit të shërbimit. Stafi ka trajnime dhe kapacitete të rritura në punën me personat e traumatizuar dhe vepron mbi parimet e shërbimeve të informuara për traumën, ashtu sikurse ka formim dhe trajnime në fushën e shërbimeve afirmuese.

STANDARDI 7

TË DHËNAT PERSONALE TË PËRFITUESVE DHE ADMINISTRIMI I TYRE

Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Të drejtat e përfitueses/përfituesit të shërbimit mbrohen nga legjislacioni në fuqi që rregullon të dhënat e kësaj natyre, si dhe rregullat e përcaktuara në rregulloren e strehëzës, për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave.

Standardi: Mbledhja dhe ruajtja e të dhënave personale të përfitues/eve të shërbimeve në strehë të kryhet duke siguruar përdorimin e tyre në mënyrë profesionale. Ofruesi i shërbimit ruan dhe përpunon të dhënat për rastet e trajtuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbështetet në parimin e ruajtjes së fshehtësisë së të dhënave dhe garantimin e konfidentalitetit të rasteve.

Kriteret e përmbushjes së standardit	Prova që tregojnë përmbushjen e kriterit (treguesi i cilësisë)	Udhëzime
Dosja të jetë konfidenciale dhe të mund të shihet vetëm nga përfituesi/përfituesja, punonjësja/punonjësi i rastit dhe menaxherja/menaxheri i shërbimit. Për identifikimin e përfitueses/përfituesit në dosje të përdoren vetëm numra të zgjedhur në mënyrë të rastësishme.	Të dhënat personale mbahen në dosje të mbyllura ose, nëse ruhen në kompjuter, mund të hapen vetëm me fjalëkalim nga personi përgjegjës.	Meqenëse këto janë raste komplekse dhe shpesh emergjence, çdo informacion i mbledhur ka rëndësi të veçantë dhe duhet të ruhet në mënyrën e duhur.
Ofruesi i shërbimit të strehëzës ka një rregullore të qartë ku përshkruhen saktësisht e me gjuhë të kuptueshme të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfitueses/ përfituesit dhe detyrimi i stafit për të informuar përfitueset/përfituesit në lidhje me këto të drejta.	Rregullorja me të drejtat dhe përgjegjësitë e përfitueses/përfituesit, e afishuar dhe e përgatitur me një gjuhë të qartë e të kuptueshme.	Ofruesi i shërbimit duhet të jetë në gjendje të vlerësojë se deri në cilën masë respektohet konfidentaliteti i të dhënave dhe duhet të njoftojë edhe përfituesen/përfituesin kur ky konfidentalitet duhet të thyhet. Përfitueset/përfituesit informohen në lidhje me të drejtën e tyre për ankimim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kur cenohet konfidentaliteti i të dhënave.



Stafi i punësuar apo i kontraktuar nga shërbimi nënshkruan një deklaratë mbi respektimin e konfidencialitetit të të dhënave të personave LGBTI+, si dhe detyrimet që lidhen me përpunimin e të dhënave dhe detyrime të tjera, të cilat burojnë nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.	Deklarata e konfidencialitetit e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e stafit, e cila është pjesë e dosjes së stafit.	Parimi i ruajtjes së konfidencialitetit dhe i rasteve kur ky parim nuk respektohet plotësisht (për shembull kur ka parashikim ligjor për të denoncuar menjëherë rastin e dhunës së ushtruar), të afishohet dukshëm në ambientet e qendrës.
Çdo vizitore/vizitor në qendër, për arsye pune, studimore etj., plotëson deklaratën e konfidencialitetit dhe të ruajtjes së të dhënave.	Formati i deklaratës së konfidencialitetit për vizitoret/vizitorët në qendër.	Dosja me formularët e plotësuar, së bashku me një formacion mbi vizitat e kryera dhe qëllimin e tyre.
Ofruesi i shërbimit ka të përcaktuar qartë se çfarë përfshihet në të dhënat personale në rregulloren e tij dhe ka një sistem që siguron ruajtjen, konfidencialitetin dhe arkivimin e të dhënave.	Ofruesi ka një rregullore të miratuar për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. ⁶	Rregullorja e mbrojtjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale, e përgatitur me gjuhë të kuptueshme dhe e vënë në dispozicion edhe të përfituesve për dijeni.
Trajtimi i të dhënave të kryhet duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, rregulloret e ofruesit të shërbimit, si dhe në marrëveshjet dhe protokollet e bashkëpunimit me institucionet përkatëse. Stafi që punon me përfituesen/përfituesin është i detyruar të respektojë kuadrin ligjor dhe aktet nënligjore në fuqi për ruajtjen e të dhënave personale dhe klasifikimin e tyre sipas rëndësisë për të mos dëmtuar përfituesen/përfituesin e shërbimit.	Personat që duhet të kenë akses te të dhënat janë stafi i ofruesit të shërbimit që përkujdeset direkt për përfituesen/përfituesin në fjalë. Të dhënat duhet të ruhen në një kasafortë, dollap me çelës, databazë të ruajtur me fjalëkalim etj.)	Ofruesi i shërbimit kujdeset që jo çdokush të ketë akses në të dhënat e klasifikuara si konfidenciale. Aksesit në të dhënat personale sigurohet vetëm në përputhje me përcaktimet ligjore dhe aktet nënligjore për këtë qëllim dhe me rregulloren e brendshme të ofruesit të shërbimit. Ofruesi i shërbimit ofron një sistem të sigurt për ruajtjen e dokumentacionit dhe arkivimin e tij. Ai mban një procesverbal të shkruar, ku evidentohen personat/institucionet e treta, të cilët do të përdorin këto dokumente.
Përfituesja/përfituesi ka akses në dosjet dhe të dhënat e saj/tij individuale.	Përfitueset/përfituesit konfirmojnë se ato/ata kanë pasur akses në dosjet e të dhënat e tyre individuale	Vërtetimet me shkrim në lidhje me pasjen e aksesit nga përfitueset/përfituesit mbi dosjet e tyre personale.
Të dhënat e përfitueses/përfituesit duhet të ruhen të paktën për një periudhë 5-vjeçare.	Një dosje me të dhëna të ruajtura në formë shkresore dhe në kompjuter.	Pas përfundimit të periudhës 5-vjeçare këto të dhëna arkivohen. Pas kësaj periudhe të dhënat më të rëndësishme për çdo përfitues/përfitues ruhen në formë kompjuterike, ndërsa dokumentet në formë të shkruar asgjësohen

⁶ Sipas ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar; c) urdhrat, udhëzimet dhe vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



STANDARDI 8 MONITORIMI DHE VLERËSIMI I SHËRBIMEVE

Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Garantimi i cilësisë së lartë të shërbimeve përmes monitorimit dhe përmes vlerësimit të vazhdueshëm të tyre.

Standardi: Ofruesi i shërbimeve të strehimit për të rejtat/rinjë LGBTI+ monitoron dhe vlerëson cilësinë e shërbimeve të ofruara në mënyrë të vazhdueshme, duke nxjerrë mësim nga këto procese, për të garantuar dhe rritur cilësinë e tyre.

Kriteret e përmbushjes së standardit	Prova që tregojnë përmbushjen e kriterit (treguesi i cilësisë)	Udhëzime
Ofruesi i shërbimeve duhet të ketë strukturën e vet, së cilës t'i jetë ngarkuar detyra e monitorimit dhe e vlerësimit të brendshëm, duke mbajtur në konsideratë standardet që duhet të arrihen për cilësinë e shërbimit.	Personat përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin janë të identifikuar në organigramë dhe përshkrimet e punës.	Është mirë të tregohet gjithmonë kujdes për zhvillimet në fushën e udhëzimeve për praktikën më të mira dhe synimet e sigurisë, vetëmjaftueshmërisë dhe fuqizimit.
Ofruesi i shërbimit ka ndërtuar një sistem për monitorimin e zbatimit të procedurave dhe njëkohësisht për vlerësimin e efektivitetit të shërbimeve.	Procedura e monitorimit dhe e vlerësimit të kryer, e dokumentuar hap pas hapi.	Proceset e monitorimit dhe të vlerësimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara, si dhe përputhshmërisë me standardet e kërkuara, të dokumentuara me shkrim.
Monitorimi dhe vlerësimi kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe të paktën një herë në tre muaj. Rezultatet paraqiten në një raport të veçantë, ku vëmendje i kushtohet numrit, cilësisë dhe rezultateve të shërbimeve të ofruara. Raportet e monitorimit dhe të vlerësimit diskutohen në strukturat përkatëse menaxhuese, si edhe me stafin dhe çojnë në përshtatjen e aktiviteteve/programave nëse është e nevojshme.	Ka dokumentacion (procesverbale, protokolle etj.) që regjistrojnë zbatimin e procedurës së monitorimit. Raportet e monitorimit dhe të vlerësimit. Shënime/minutat nga mbledhjet e organizuara, në të cilat janë diskutuar raportet e monitorimit dhe të vlerësimit.	Lista e rezultateve dhe e rekomandimeve nga proceset e vazhdueshme të monitorimit, e konsultuar edhe me përfitueset dhe përfituesit e shërbimit, mbahet në konsideratë dhe përdoret si bazë për çdo ndërhyrje për zgjerim apo përmirësim të shërbimit.
Përfitueset/përfituesit janë të përfshirë në procesin e monitorimit. Çdo raport monitorimi dhe vlerësimi duhet të marrë parasysh opinionin e personave që kanë përfituar nga shërbimet e ofruara.	Mendime dhe pyetësorë të plotësuar nga përfitueset/përfituesit e mëparshme/ëm, intervista dhe fokus-grupe me përfituesit dhe aktorët e tjerë.	Një kuti e vendosur në ambientet e qendrës, ku përfitueset dhe përfituesit janë të lirë të shkruajnë dhe të depozitojnë opinionet e tyre mbi shërbimet e marra dhe mënyrën e trajtimit nga ana e stafit. Këto të dhëna i bashkëlidhen informacionit të mbledhur nga mjetet e tjera të monitorimit dhe vlerësimit, sa herë që këto procese kryhen.

VII. REFERENCAT

Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

<https://genderspectrum.org/articles/understanding-gender>

<https://www.lgbtqihealtheducation.org/publication/lgbtqi-glossary-of-terms-for-health-care-teams/>

<https://genderspectrum.org/articles/myths>

<https://srlp.org/wp-content/uploads/2012/08/TransitioningOurShelters.pdf>

https://www.wpath.org/media/cms/Documents/SOC%20v7/Standards%20of%20Care_V7%20Full%20Book_English.pdf

<http://yogyakartaprinciples.org/principle-12>



VENDIM
Nr. 22, datë 29.4.2021

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese		
Elsa Toska	anëtare e	“	“
Marsida Xhaferllari	anëtare e	“	“
Fiona Papajorgji	anëtare e	“	“
Altin Binaj	anëtar i	“	“
Përparim Kalo	anëtar i	“	“
Sonila Bejtja	anëtare e	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 29.4.2021, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, kërkesën nr. 3 (S) 2018 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “MIRËSIA” SH.P.K.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave (DASHP) pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shoqëria “Armo” sh.a., Ervehe Vrioni, Arjan Vrioni, Gjylysha Shkurti (Vrioni), Entela Abedini (Vrioni), Agjencia e Trajtimit të Pronave.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 4176, datë 13.11.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe nr. 00-2017-2163, datë 27.9.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: nenet 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 71 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, aktet e paraqitura nga

subjekti i interesuar Arjan Vrioni, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesja, shoqëria “Mirësia” sh.p.k., ka lidhur me shoqërinë “Armo” sh.a. kontratën noteriale të sipërmarrjes nr. 165 rep., nr. 42 kol., datë 29.10.1999, me afat 10-vjeçar, me objekt: “*Sipërmarrja e shërbimit të shitjes në stacionin e shitjes së karburanteve në Ura vajgurore, stacion pranë Degës së Karburanteve Lushnje të shoqërisë “Armo” sh.a. Fier.*”. Me kontratën e shitjes së datës 9.12.2009, Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike dhe shoqëria “Armo” sh.a., u kanë shitur objektin “pikë shitje karburanti”, në Urën Vajgurore Berat, shtetasve Arjan Vrioni, Ervehe Vrioni, Gjylysha Shkurti (Vrioni) dhe Entela Abedini (Vrioni), në cilësinë e ish-pronarëve të truallit ku është ndërtuar ky objekt, i cili ka qenë në posedim të kërkesueses. Kjo kontratë është regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat dhe prona ka kaluar në pronësi të blerësve. Për rrjedhojë, kërkesja i është drejtuar gjykatës me padi për zgjidhjen e pasojave juridike të pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes të datës 9.12.2009 dhe detyrimin e palëve të paditura të privatizojnë objektin në favor të saj.

2. Me vendimin nr. 6238, datë 18.6.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: “*Pranimin e padisë së palës paditëse shoqëria “Mirësia” sh.p.k. Zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes... datë 9.12.2009 dhe vendimit të KKKP-së Berat... duke urdhëruar fshirjen e regjistrimit hipotekor... në emër të të paditurve... Detyrimin e palëve të paditura Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike dhe shoqëria “Armo” sh.a., të privatizojnë në favor të palës paditëse shoqëria “Mirësia” sh.p.k. objektin e emërtuar “pikë e shpërndarjes së karburantit Ura Vajgurore” Berat.*”. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim subjektet e interesuara.

3. Me vendimin nr. 2694, datë 20.12.2013, Gjykata e Apelit Tiranë ka shpallur moskompetencën për shqyrtimin e kësaj çështjeje



dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

4. Me vendimin nr. 4176, datë 13.11.2014, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 6238, datë 18.6.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rrëzimin e kërkesëpadisë.” Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kërkujesja, shoqëria “Mirësia” sh.p.k.

5. Me vendimin nr. 00-2017-2163, datë 27.9.2017, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (ligji nr. 49/2012).

6. Me kërkesën e datës 29.1.2018, kërkujesja, shoqëria “Mirësia” sh.p.k., i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit të saj.

7. Në datën 30.5.2018, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

8. Prej datës 23.3.2018, Gjykata Kushtetuese nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor për formimin dhe funksionimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve për shqyrtimin paraprak të çështjeve, të kërkuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000. Pas plotësimi të këtij kuorumi u bë e mundur marrja në shqyrtim e kësaj çështjeje.

9. Me vendimin e datës 22.1.2021, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

II

Pretendimet e palëve

10. **Kërkujesja** pretendon se procesi i zhvilluar në gjykatat e zakonshme i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, në këto aspekte të kësaj së drejte:

10.1. *E drejta e aksesit*, sepse Gjykata Administrative e Apelit nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkujeses dhe vendimi është dhënë në shkelje dhe zbatim të gabuar të dispozitave të ligjit material. Arsyetimi se paditësja nuk legjitimohet në ngritjen e kësaj padie bie në kundërshtim me dispozitat ligjore, ndërkohë që nga

faktet e administruara në dosje rezulton se kërkujesja ka lidhur me shoqërinë “Armo” sh.a. kontratën e datës 29.10.1999 me afat 10-vjeçar, e cila i përfundonte efektet në datën 29.10.2009. Gjatë kësaj kohe ka dalë ligji nr. 9967, datë 24.7.2008 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve” (ligji nr. 9967/2008), në të cilin përcaktohet se privatizimi i pronës shtetërore dhe kriteret e tij do të bëhen sipas akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij. Në këtë mënyrë aksesit i kërkujeses në gjykatën e apelit ka qenë formal, duke mos marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet e saj.

10.2 *Parimi i barazisë së armëve*, sepse gjykata e apelit nuk ka zbatuar parimin e kontradiktoritetit në gjykim dhe ka vlerësuar të ligjshme pretendimet e ngritura në ankim pa bërë analizën e kundërshtimeve të ngritura nga pala paditëse. Fakti që në vendim nuk parashtrohen argumentet e paditësës për paligjshmërinë e ankimit, tregon se ajo gjykatë nuk e ka dëgjuar këtë palë.

10.3 *Standardi i arsyetimit të vendimit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit, nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të ngritura në rekurs. Ky vendim është alogjik dhe nuk përmbush as kërkesat minimale të arsyetimit.

10.4 *Parimi i gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm*, për arsye se gjykimi në Gjykatën e Lartë nuk është kryer brenda afatit 90-ditor, të parashikuar në nenin 60, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Lartë në vitin 2014 dhe gjykimi është bërë pas rreth 3 vjetësh.

11. **Subjekti i interesuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë**, përfaqësuar nga Avokati i Shtetit, në parashtrimet e paraqitura me shkrim ka prapësuar sa vijon:

11.1 Avokatura e Shtetit përfaqëson në këtë çështje ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, që sot është një institucion i vetëm, i cili ka gëzuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet e derivuara edhe nga ish-Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe që aktualisht e ushtron veprimtarinë, në përputhje me



legjislacionin përkatës, në fushat e financave, ekonomisë, tregtisë, sipërmarrjes, punësimit etj.

11.2. Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit është i pabazuar, pasi kërkuësja jo vetëm ka pasur mundësinë t'i drejtohet gjykatës, por është njohur në kohë me pretendimet e palëve të tjera, me kërkesën ankimore të tyre, duke iu dhënë mundësia të paraqesë edhe argumentet e parashtrimet e saj për çështjen dhe kundërshtimet në lidhje me ankimet e palëve të tjera në gjykim.

11.3 Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve është i pabazuar. Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, e ka zhvilluar procesin gjyqësor me praninë e palëve, për shkak të kompleksitetit dhe rëndësisë së çështjes, duke respektuar standardet e së drejtës për një proces të rregullt. Procesi në atë gjykatë është zhvilluar në referim të provave, akteve shkresore dhe pohimeve/debatit gjyqësor.

11.4 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Në përputhje me jurisprudencën kushtetuese, arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit të saj është tregues i faktit se kërkuësja nuk ka ngritur asnjë nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm që është kusht për praninë e kërkesës. Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, në faqen 2 të vendimit ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs dhe iu ka dhënë përgjigje se nuk janë nga ato që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Duke pasur parasysh edhe natyrën e këtij vendimi, ai përmbush standardet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

11.5 Në lidhje me pretendimin për mosshqyrtimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm, pas hyrjes në fuqi të dispozitave të reja procedurale civile këto çështje shqyrtohen nga gjykatat e zakonshme dhe nuk bëjnë më pjesë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Pretendimi i kërkuësës është i pambështetur, duke pasur parasysh edhe ngarkesën shumë të madhe të çështjeve gjyqësore në pritje për t'u shqyrtuar nga ajo gjykatë. Çështja është regjistruar në datën 29.4.2015 dhe Gjykata e Lartë është shprehur me vendimin e datës 27.9.2017, çka është një periudhë

kohore e arsyeshme për shqyrtimin e çështjes nga gjykatat e zakonshme.

12. **Subjekti i interesuar, Arjan Vrioni**, ka paraqitur para Gjykatës disa vendime gjyqësore që lidhen me këtë çështje, nga të cilat rezulton se me vendimin nr. 1258, datë 5.12.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur: “*Pranimin e padisë së paditësve Arjan Vrioni, Gjylysha Shkurti (Vrioni), Ervebe Vrioni dhe Entela Abedini (Vrioni). Detyrimin e të paditurit shoqërisë “Mirësia” sh.p.k., t'i lirojë dhe dorëzojë paditësve, pasurinë e paluajtshme, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat... Ura Vajgurore Berat, sipas plan vendosjes së aktit të ekspertimit teknik shtesë..., pjesë përbërëse e vendimit. Detyrimin e të paditurit shoqërisë “Mirësia” sh.p.k. t'i paguajë paditësve shumën prej 1,024,654 lekë si shpërblim për përdorimin e sendit.*”. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 942, datë 14.11.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe për të është lëshuar edhe urdhri i ekzekutimit.

13. **Subjektet e tjera të interesuara** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim në lidhje me pretendimet e ngritura në kërkesën në shqyrtim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

14. Gjykata vëren se, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, llojin e pasojave negative të pësura dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Kërkuësja legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, pasi ka qenë palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe është bartëse e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës.



16. Po ashtu, kërkesja ka plotësuar edhe kërkesën tjetër të kërkuar nga kjo dispozitë kushtetuese, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 për shterimin e mjeteve juridike përpara se të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Në çështjen konkrete në shqyrtim rezulton se vendimi i fundit që ka përmbyllur procesin gjyqësor dhe ka vendosur në mënyrë përfundimtare për pretendimet e kërkuarës është vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkesja nuk ka mjet tjetër ligjor për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, të pretenduar të cenuar.

17. Kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000. Vendimi i fundit gjyqësor i kundërshtuar është ai i Gjykatës së Lartë, i datës 27.9.2017, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese në datën 29.1.2018 (ditë e hënë), e cila është edhe dita e fundit e afatit ligjor 4-mujor, në kuptim të parashikimeve të nenit 1, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 148 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

18. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit, të parimit të barazisë së armëve në gjykim dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Përveç sa më sipër, ajo ka pretenduar edhe cenimin e standardit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm në Gjykatën e Lartë. Në jurisprudencën e saj Gjykata e ka legjitimuar individin për paraqitjen e kërkesave me këtë objekt (për mosgjykimin ose mosekzekutimin e vendimit brenda afatit të arsyeshëm), në kuptim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak se legjislacioni nuk parashikonte mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Me ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 (të cilat kanë hyrë në fuqi në datën 5.11.2017) është përcaktuar se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), çfarë do të konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshejtimin e procedurave (nenet 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7) etj. Pra, ligji procedural ka parashikuar

mjete ligjore efektive me qëllim që individit t'i garantohet mbrojtja efektive në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm ose edhe për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm (*shih vendimin nr. 16, datë 16.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Ndryshimet e sipërcituara kanë hyrë në fuqi në datën 5.11.2017, kurse vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 27.9.2017, çka do të thotë se procesi gjyqësor i kundërshtuar ka përfunduar në të tria shkallët e gjykimit përpara hyrjes në fuqi të mjeteve të reja të mbrojtjes ligjore. Gjithashtu, konstatohet se ligji nuk ka parashikuar efekte prapavepruese për çështjet e përfunduara në datën e hyrjes së tij në fuqi. Në këtë kuptim, kërkesja nuk ka mjet tjetër efektiv përveç kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

20. Për sa më sipër, pretendimet e parashtruara nga kërkesja janë shqyrtuar në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykim

21. Sipas kërkuarës, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të saj dhe vendimi është dhënë në shkelje dhe zbatim të gabuar të dispozitave të ligjit material. Arsytimi se paditësja nuk legjitimohet në ngritjen e kësaj padie është në kundërshtim me dispozitat ligjore, ndërkohë që nga faktet e administruara rezulton se kërkesja ka lidhur me shoqërinë “Armo” sh.a. kontratën e datës 29.10.1999, me afat 10-vjeçar, e cila i përfundonte efektet në datën 29.10.2009. Gjatë kësaj kohe ka dalë ligji nr. 9967/2008 në të cilin përcaktohet se privatizimi i pronës shtetërore dhe kriteret e tij do të bëhen sipas akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij. Sipas kërkuarës, aksesit në gjykatën e apelit ka qenë formal dhe ajo nuk ka marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet e saj.

22. Sipas subjektit të interesuar, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit është i pabazuar. Kërkesja jo vetëm ka pasur mundësinë t'i drejtohet gjykatës, por është njohur në kohë me pretendimet e palëve të tjera, me kërkesën ankimore të tyre, duke iu dhënë mundësia të paraqesë edhe argumentet e parashtrimet e saj për çështjen dhe kundërshtimet në lidhje me ankimet e palëve të tjera në gjykim.



23. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 12, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se Gjykata Administrative e Apelit Tiranë është vënë në lëvizje mbi bazën e ankimit të paraqitur nga palët e paditura në procesin civil (subjektet e interesuara). DASHP-ja ka parashtruar në ankimin e saj se paditësja nuk legjitimohet t'i drejtohet gjykatës, pasi fuqia juridike e kontratës së vitit 1999, e lidhur mes paditëses dhe shoqërisë “Armo” sh.a., ka mbaruar me kalimin e afatit 10-vjeçar, moment në të cilin janë shuar të gjitha të drejtat e saj mbi sendin, duke u kthyer në poseduese e paligjshme e tij. Legjitimimi i kërkuar është kundërshtuar edhe në ankimin e subjekteve të interesuar Vrioni (palë e paditur në procesin gjyqësor), sipas të cilave në momentin që paditësja (kërkuarja) i është drejtuar gjykatës nuk ka qenë në fuqi kontrata e sipërmarrjes, pasi i kishte mbaruar afati.

25. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim ankimet e palëve ndërgjyqëse, ka vlerësuar: “... Gjykata vëren se në kuptim të përmbajtjes së nenit 32 të KPC-së padia mund të ngrihet

vetëm atëherë kur paditësi vërteton interesin e tij të ligjshëm, pra kur kërkesat objekt i saj lidhen me qenien ose mosqenien e një marrëdhënieje juridike ose një të drejte... për palën paditëse njohja në favor të palës Vrioni e së drejtës së pronësisë dhe njëherësh e së drejtës reale të parablerjes së pasurisë objekt gjykimi, si edhe shitja më tej e kësaj pasurie në favor të kësaj pale, rezulton të jetë materializuar në akte dhe veprime që nuk sjellin asnjë pasojë për të, për sa kohë raporti i palës paditëse me pasurinë e hipotekuar tashmë në favor të palës Vrioni rezulton të ketë përfunduar bashkë me përmbushjen e afatit kontraktor. Në këtë kontekst, gjykata vlerëson se nëpërmjet padisë së shqyrtuar me vendimin objekt ankimi, pala paditëse ka kërkuar të vërtetojë gjyqësisht një fakt që nuk sjell asnjë pasojë juridike për të...”

26. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimues, në formë e në përmbajtje, siç sanksionohet në legjislacionin procedural, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e së drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Në përputhje me këtë, neni 31 i KPC-së e ka përkufizuar padinë si të drejtën për t'u dëgjuar të personit që ngre pretendimin, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo në fakte e në ligje, kurse neni 32, shkronja “a”, parashikon se padia mund të ngrihet për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur (*shih vendimet nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 38, datë 30.6.2014; nr. 5, datë 20.3.2006, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas nenit 12 të KPC-së, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat bazon atë. Në këtë kuptim, është pala që vë në lëvizje gjykatën që ka detyrimin të provojë pretendimet e saj dhe të paraqesë provat për këtë qëllim.

27. Gjykata vlerëson se në rastin konkret, edhe pse gjykata e shkallës së parë kishte vendosur pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga kërkuarja, gjykata e apelit, e vënë në lëvizje mbi bazën e ankimit të palëve të paditura në procesin gjyqësor, ka vendosur ndryshimin e atij vendimi pas një procesi gjyqësor, ku ka administruar dhe dëgjuar palët ndërgjyqëse, si dhe duke iu referuar normave ligjore që lidhen me të provuarit e interesit të ligjshëm për të ngritur padinë. Për sa më sipër, kërkuarja, lirisht, ka ushtruar të drejtën e ngritjes së padisë dhe përmes një procesi gjyqësor, që ka analizuar themelin e çështjes, me vendim përfundimtar ka marrë përgjigje për të gjitha



pretendimet e saj, përfshirë edhe atë të legjitimitetit aktiv.

28. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuësës për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykim është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve

29. Sipas kërkuësës, gjykata e apelit ka vlerësuar të ligjshme pretendimet e ngritura në ankim pa bërë analizën e kundërshtimeve të ngritura nga pala paditëse. Fakti që në vendim nuk parashtrohen argumentet e paditëses për paligjshmërinë e ankimit, tregon se gjykata nuk e ka dëgjuar këtë palë, duke cenuar parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në gjykim.

30. Sipas subjektit të interesuar, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, edhe ky pretendim është i pabazuar, pasi Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, e ka zhvilluar procesin gjyqësor me praninë e palëve, për shkak të kompleksitetit dhe rëndësisë së çështjes, duke respektuar standardet e së drejtës për një proces të rregullt. Procesi në atë gjykatë është zhvilluar në referim të provave, akteve shkresore dhe pohimeve/debatit gjyqësor.

31. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 13, datë 20.2.2017; nr. 34, datë 29.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 3, datë 20.1.2017; nr. 34, datë 29.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Gjykata, duke iu referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij

gjykimi kushtetues, konstaton se Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, si gjykata kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje, me urdhrin e datës 30.1.2014, ka vendosur shqyrtimin e saj në dhomën e këshillimit dhe njoftimin e palëve për përbërjen e trupit gjykues, datën e seancës dhe datën e paraqitjes së parashtimeve me shkrim. Në seancën e datës 12.2.2014, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Në seancat gjyqësore të zhvilluara në datat 20.3.2014, 12.5.2014, 23.6.2014, 11.9.2014 dhe 29.9.2014, ka qenë i pranishëm përfaqësuesi i kërkuësës, por ato janë shtyrë për mungesë të palëve të tjera. Në seancën gjyqësore të datës 10.11.2014 ka qenë i pranishëm përfaqësuesi i paditëses, që ka parashtuar pretendimet e saj dhe ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Po ashtu, në këtë seancë përfaqësuesi i palës së paditur dhe anëtarët e trupit gjykues i kanë drejtuar pyetje përfaqësuesit të paditëses. Në seancën e datës 13.11.2014, pasi palët kanë parashtuar konkluzionet përfundimtare, gjykata është tërhequr për të marrë vendim dhe ka shpallur vendimin e kundërshtuar, objekt i këtij gjykimi kushtetues.

34. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vëren se kërkuësja jo vetëm ka marrë pjesë në seancat gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën Administrative të Apelit, por ka pasur mundësinë të parashtrë, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, prapësimet kundër ankimit dhe pretendimet lidhur me thelbin e mosmarrëveshjes mes palëve. Pretendimi i kërkuësës se për sa kohë që në vendim nuk parashtrohen argumentet e saj për paligjshmërinë e ankimit, kjo tregon se gjykata nuk e ka dëgjuar këtë palë, nuk është i bazuar. Gjykata e apelit ka parashtuar në vendim shkaqet e parashtuara në ankimet që e kanë vënë atë në lëvizje, ndërkohë që në arsyetimin e vendimit ajo ka parashtuar të gjitha faktet që kanë rezultuar nga aktet e administruara, duke paraqitur argumentet e saj se përse nuk e ka gjetur të bazuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

35. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuësës për cenimin e parimit të barazisë së armëve në gjykim është i pabazuar.



Ç. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

36. Sipas kërkukses edhe pse pretendimet në lidhje me procesin e zhvilluar në gjykatat e faktit janë ngritur në rekurs, ato nuk janë marrë në shqyrtim nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e tij në dhomën e këshillimit. Ky vendim është alogjik dhe nuk përmbush as kërkesat minimale të arsyetimit.

37. Sipas subjektit të interesuar, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ky pretendim është i pabazuar, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë përmbush standardet e së drejtës për një proces të rregullt. Në përputhje me jurisprudencën kushtetuese, arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit të saj është tregues i faktit se kërkuësja nuk ka ngritur asnjë nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, në fagen 2 të vendimit ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs dhe iu ka dhënë përgjigje se nuk janë nga ato që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012.

38. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Domosdoshmëria e arsyetimit të vendimeve gjyqësore është një garanci për procesin ligjor. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Në lidhje me vendimet e mospranimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata ka vlerësuar se dhoma e këshillimit, sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, nëpërmjet arsyetimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih*

vendimin nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese). Nga ana tjetër, për sa i përket arsyetimit të kufizuar të vendimeve të dhomës së këshillimit, jurisprudenca kushtetuese ka vlerësuar se kërkesat e një procesi të rregullt ligjor mund të plotësohen edhe me një arsyetim të kufizuar të këtyre vendimeve (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 9, datë 26.3.2018; nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Gjykata vëren se sipas nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar. Bazuar në këtë dispozitë, në lidhje me pretendimin e kërkukses se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk plotëson standardin e arsyetimit, pasi nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura prej saj në rekurs, në kushtet kur nuk u arrit shumica e votave⁷ në lidhje me bazueshmërinë ose jo në themel të këtij pretendimi, ai konsiderohet i rrëzuar.

D. Për pretendimin për mosgjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

41. Kërkuësja pretendon cenimin e parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, pasi gjykimi në Gjykatën e Lartë nuk është kryer brenda afatit 90-ditor, të parashikuar në nenin 60, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Sipas saj, kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Lartë në vitin 2014 dhe shqyrtimi i saj është bërë në vitin 2017, pas rreth 3 vjetësh.

42. Sipas subjektit të interesuar, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, pas hyrjes në fuqi të dispozitave të reja procedurale civile këto çështje shqyrtohen nga gjykatat e zakonshme dhe nuk bëjnë më pjesë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Pretendimi i kërkukses është i pambështetur, duke pasur parasysh numrin e çështjeve në pritje për t'u shqyrtuar nga ajo gjykatë. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 29.4.2015 dhe ajo është shprehur me vendimin e datës 27.9.2017, çka është një periudhë kohore e arsyeshme për shqyrtimin e çështjes nga gjykatat e zakonshme.

43. Gjykata lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të

⁷ Votuan për pranimin e këtij pretendimi gjyqtarët: Marsida Xhaferllari, Përparim Kalo dhe Sonila Bejtja.

Votuan për rrëzimin e këtij pretendimi gjyqtarët: Vitore Tusha, Elsa Toska, Fiona Papajorgji dhe Altin Binaj



rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkesës, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 1, datë 21.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, për të arritur në konkluzionin nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhet të vlerësohet analiza e secilit prej elementeve të sipërcituara.

i. Periudha që duhet marrë në konsideratë

44. Lidhur me pretendimin për kohëzgjatjen e procesit në Gjykatën e Lartë tej afatit të arsyeshëm, nga aktet e dosjes gjyqësore Gjykata vëren se kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 29.4.2015 dhe me vendimin e datës 6.9.2017 të gjyqtarit relator është vendosur shqyrtimi i saj në dhomën e këshillimit në datën 27.9.2017. Në këtë datë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga shoqëria “Mirësia” sh.p.k. Për pasojë, rezulton se vendimi i Gjykatës së Lartë për këtë çështje është marrë pasi kanë kaluar 2 vjet e 5 muaj nga regjistrimi i saj.

ii. Kompleksiteti i çështjes

45. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e saj, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Në rastin në shqyrtim Gjykata konstaton se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, gjykimi i të cilave parashikohet dhe rregullohet nga ligji nr. 49/2012. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, Gjykata vëren se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta ose komplekse që mund të justifikojnë një vonesë në shqyrtimin e saj, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuarës është me rëndësi në këtë kontekst.

iii. Interesi dhe sjellja e kërkuarës

47. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuarës është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës, Gjykata çmon se kërkuarësja nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë.

iv. Sjellja e autoriteteve

48. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet të cilat marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme.

49. Lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka vërejtur se neni 3 i ligjit nr. 49/2012, ndër parimet e gjykimit administrativ, ka përcaktuar sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e këtyre gjykatave. Ligji nr. 49/2012 synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative dhe në këtë drejtim qëllimi i krijimit të gjykatave administrative është garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Afatet konkrete të përcaktuara në ligj për gjykimin e çështjeve duhet të zbatohen nga gjykatat administrative për shqyrtimin e çështjeve. Për më tepër, ligji nr. 49/2012 ka parashikuar afate të mirëpërcaktuara për gjykimin në shkallë të parë (neni 25 – për veprimet përgatitore, neni 27 - për caktimin e seancës gjyqësore), për gjykimin në apel (neni 48, pika 2 – për shqyrtimin e çështjes nga gjykata e apelit), si dhe për gjykimin në Gjykatën e Lartë (neni 60, pika 2 – rasti në shqyrtim) (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 59, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Gjykata është shprehur se respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural



nga ana e gjykatave më të ulëta. Po në këtë këndvështrim, Gjykata në çështje të ngjashme ka vlerësuar se justifikimet se shkak i vonesës është numri i lartë i çështjeve që kanë në shqyrtim këto gjykata, nuk janë të bazuara. Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt është detyrë e këtij të fundit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 3, datë 6.12.2018; nr. 46, datë 3.7.2017; nr. 59, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

51. Në këto kushte, Gjykata çmon se çështja në Gjykatën e Lartë nuk është gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi kjo e fundit ka marrë vendim pasi kanë kaluar 2 vjet e 5 muaj pas regjistrimit të saj, çka në raport me afatin ligjor 90-ditor është një kohëzgjatje e paarsyeshme. Për pasojë, pretendimi i kërkuar për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjyimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda afatit të arsyeshëm, është i bazuar.

52. Në përfundim, bazuar në arsyetimin e mësipërm, Gjykata çmon se në rastin konkret është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjyimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda afatit të arsyeshëm të parashikuar nga neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72, 73, pika 4, e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 29.4.2021

Shpallur, më 21.5.2021

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Përparim Kalo

VENDIM

Nr. 116, datë 30.4.2021

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQATËS AREA, PËR SHTYRJEN E HYRJES NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 106, DATË 2.7.2020

Në mbështetje të neneve 16, 19, 62, 98, 99, pika 1 dhe 2 dhe 100, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 8 dhe nenit 22, pika 5, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; si dhe të nenit 15 dhe 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 3.9.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 64/1 prot., datë 28.4.2021, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqatës AREA për shtyrjen e hyrjes në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 275, datë 28.12.2020, “Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për shtyrje të afatit të hyrjes në fuqi të vendimit nr. 106, datë 2.7.2020”, ndër të tjera vendosi që OST sh.a. dhe pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike të vijnë në aplikimin e periudhës *dry run* deri në datën 31.3.2021.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, OST sh.a. ka vijuar me operimin e fazës *dry run* të rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s



nr. 106, datë 2.7.2020, përgjatë gjithë kësaj periudhe kohore.

- Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA), nëpërmjet shkresës nr. 1810/102 prot., datë 31.3.2021, ka parashtruar në ERE kërkesën për shtyrjen e afatit të hyrjes në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, me një periudhë shtesë 9-mujore, deri në 31.12.2021, duke argumentuar se:

1. Ligji 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, në nenin 99, pika 4, shprehet se: “mënyra e trajtimit të disbalancave të shkaktuara nga prodhuesit me përparësi dhe kostot përkatëse për mbulimin e tyre, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Deri tani nuk ka asnjë vendim të Këshillit të Ministrave, për këtë qëllim. Prodhuesit me përparësi janë në pritje të këtij vendimi dhe presin të jenë pjesë aktive e hartimit të tij. Është e qartë se vendimi i Bordit të ERE-s nuk mundet kurrësi të vijë në shkelje të ligjit në sektorin e energjisë elektrike pasi do të shkelte kështu parimin e mandatuar në Kushtetutë për hierarkinë e normave ligjore, ku aktet ligjore prevalojnë mbi vendimet organike të organeve administrative.

2. Ligji 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, në nenin 100, pika 3, shprehet se: “deri në krijimin e tregut të balancimit, tarifat për realizimin e shërbimit të balancimit vendosen sipas metodologjisë së miratuar nga ERE”. Kjo metodologji duhet të reflektojë kostot dhe të bëhet publike. Deri tani në dijeninë tonë, ne nuk kemi asnjë informacion për kostot që prodhuesit me përparësi shkaktajnë me disbalancat e tyre dhe metodologjinë përkatëse.

3. VKM-ja nr. 480/2018, “Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018– 2030”, citon se: “Të gjitha impiantet e energjisë BRE (burimet e rinovueshme) janë të ndara në dy grupe, me kapacitet më të ulët se 2 mw, nuk do të kenë përgjegjësi balancuese dhe të gjitha BRE-të me kapacitet të instaluar më shumë se 2 mw do të kenë përgjegjësi balancuese. Çdo tarifë balancuese/ penalitet do të aplikohet për mospërbushjen e përgjegjësi balancuese dhe do të vendoset me vendim të Këshillit të Ministrave, që duhet të hartohen dhe miratohen për zbatimin praktik të kërkesave ligjore të bursës shqiptare të energjisë dhe BRE”. Kjo kërkesë e VKM-së nuk është realizuar akoma. Gjithashtu është e qartë se të

gjithë prodhuesit me përparësi, me kapacitet me të vogël se 2 mw, janë të përjashtuar nga kostot e balancimit.

4. Në Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 275, datë 28.12.2020, në të cilën merret në diskutim kërkesa e OST për shtyrjen e afatit të Bordit të ERE-s, së vendimit nr. 106, datë 2.7.2020, OST parashtron se: “në kushtet kur ende nuk janë konkluduar marrëveshjet përkatëse me kontraktorët e ardhshëm...”, duke mos u përcaktuar qartë që bëhet fjalë për regjistrimin e BRE-ve, të cilët nuk kanë marrë asnjë lloj njoftimi, as përpara, as pas këtij vendimi. Pika 4, e këtij vendimi përmend një raport vlerësimi për fazën *dry run* nga OST-ja, ku renditet dhe procesi i regjistrimit të pjesëmarrësve në Tregun Shqiptar të Balancimit, por prodhuesit me përparësi nuk kanë qenë pjesë e këtij informacioni megjithëse në numër përbëjnë numrin më të madh të pjesëmarrësve në treg. Pra as OST-ja as ERE nuk kanë bërë asnjë veprim për të informuar prodhuesit me përparësi, për hapat që duhet të ndërmerrnin, së pari regjistrimin e sipërmarrjes së tregut me përparësi, kosto e tyre të balancimit, duke shkelur kështu edhe vetë pikën 2 dhe 3, të vendimit nr. 106, datë 2.7.2020 dhe detyrimin ligjor të ERE-s për të konsultuar me grupin e interesit miratimin e rregullores.

- Në vijim të këtyre parashtrimeve, AREA bën me dije se kërkesa e saj, si përfaqësuese e prodhuesve me përparësi, për shtyrjen e afatit të hyrjes në fuqi të rregullave të Tregut të Balancimit për prodhuesit me përparësi deri në plotësimin e kushteve të mësipërme, për të cilat mendon që afati më i shkurtër do të ishte të paktën deri më 31.12.2021, është plotësisht e legjitimuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 118, datë 22.7.2019, vendosi të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” bashkë me anekset përkatëse, të propozuara nga OST sh.a. Në vijim të këtij vendimi, palët e interesit u njoftuan me anë të shkresës nr. 330/2 prot., datë 31.7.2019, për diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e opinionit lidhur me disa aspekte të parashikimeve të këtyre rregullave. Ndër të tjera nëpërmjet kësaj shkrese janë njoftuar për të dhënë opinionet përkatëse Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, OSHEE sh.a., KESH sh.a., Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë



Elektrike (AAES), Shoqata *Foreign Investors Association Of Albania* (FIAA) dhe Shoqata *Albanian Renewable Energy Association* (AREA).

- ERE, më datë 10.10.2019, zhvilloi një seancë dëgjimore, ku ka qenë prezent edhe AREA. Gjithashtu, vlen të përmendim edhe se vendimet e ERE-s publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe botohen në Fletoren Zyrtare, me qëllim lehtësimin e aksesimit të tyre nga ana e palëve të interesit dhe publikut në tërësi. Shoqëria OST sh.a., gjithashtu, në faqen e saj web ka hapur një rubrikë të veçantë për procesin e *dry run*, me informacionin e nevojshëm për të gjithë pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike, përfshirë edhe prodhuesit me përparësi, anëtarë të shoqatës AREA, në mënyrë që të marrin informacionin e nevojshëm për ecurinë dhe procesin e periudhës *dry run*.

- Në vijim, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020, vendosi “Miratimin e rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, vendim në të cilin është përcaktuar faza e parë e zbatimit të këtyre rregullave në procesin *dry run*, deri në datën 31.12.2020, fazë e cila u zgjat me një periudhë të dytë deri në datën 31 mars 2021.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 99, pika 1, përcakton qartë se: “Çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike”, dhe në pikën 2 se: “Pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike mund të rregullojnë përgjegjësinë për balancimin, nëpërmjet një kontrate me Operatorin e Sistemit të Transmetimit, duke marrë statusin e palës përgjegjëse për balancim ose duke nënshkruar një kontratë për transferimin e përgjegjësisë së balancimit ndaj një pale tjetër përgjegjëse për balancimin, duke u bërë pjesëtar i një grupi balancues, në përputhje me rregullat e tregut”.

- Si dhe parashikuar në dispozitat sipërcituar, ligji përcakton detyrimin për përgjegjësinë e balancimit, si dhe krijon kushte për një përfshirje të drejtpërdrejtë si palë përgjegjëse për balancimin apo edhe si grup balancimi. Palët, përfshi dhe prodhuesit me përparësi duhet të vlerësojnë vetë se cilat nga format e lejuara nga ligji, ajo e krijimit të një grupi balancimi apo ajo e të qenurit si palë përgjegjëse për balancimin është me kosto sa më minimale për ta.

- Ligji nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjive nga burime të rinovueshme”, në nenin 8, pika 4, përcakton se: “Prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike janë përgjegjës për balancimin. Prodhuesit bëhen palë përgjegjëse për balancimin, duke nënshkruar një kontratë me Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose duke nënshkruar një kontratë për transferimin e përgjegjësisë së balancimit të një palë tjetër përgjegjëse për balancimin, duke u bërë pjesëtar i një grupi balancues, në përputhje me rregullat e tregut dhe procedurat përkatëse të miratuara nga ERE, në konsultim me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë”.

- Në vijim të përcaktimeve ligjore, konkretisht në nenin 22, pika 5, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjive nga burime të rinovueshme” përcaktohet specifikisht se: “Deri në krijimin e tregut të balancimit, por jo më vonë se data 31 dhjetor 2022, prodhuesit ekzistues me përparësi nuk do të jenë përgjegjës për kostot e disbalancave të shkaktuara. Këto kosto do të merren në konsideratë nga ERE në tarifën e shpërndarjes së energjisë elektrike. Prodhuesit ekzistues me përparësi do të njoftojnë skedulin e prodhimit të Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike.”.

- Kontrata për shit-blerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, ndryshuar me vendimin nr. 147, datë 30.9.2016, dhe vendimin nr. 255, datë 24.12.2018, në nenin 5 (Programet e livrimit), pika 5, përcakton se: “Devijimet nga programet e paraqitura do të trajtohen në përputhje me “Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike” apo çdo akti tjetër të miratuar nga ERE për këtë qëllim. Kjo kontratë e cila është nënshkruar nga vetë këta prodhues si palë direkte në të, është në zbatim e sipër.

- Gjithashtu, përveç faktit të marrjes pjesë përgjatë trajtimit të vendimmarrjes së ERE-s nga ana e palëve të interesuara, përfshirë këtu dhe shoqatën e prodhuesve, në thelb tregu Shqiptar i Balancimit kërkon nga palët, qofshin këto palë përgjegjëse për balancimin apo dhe pjesë e grupit të balancimit, përcjelljen e programeve të skedulimit tek OST sh.a. ose të grupi i balancimit, proces i cili është i parashikuar në aktet ligjore në fuqi. Si pasojë



ky është një proces i cili nuk është i ri në treg, përkundrazi duhet të ishte bërë me kohë nga të gjithë pjesëtarët e tregut, si rrjedhojë është një proces rutinë i operimit të centraleve nga ana e të licencuarve.

- Në çdo rast duhet theksuar se, nga ana e operatorit apo palës përgjegjëse balancuese, për mënyrën e trajtimit të disbalancave të shkaktuara nga pjesëmarrësit e tregut do të zbatohet legjislacioni në fuqi.

- Për sa i takon pretendimit për kostot e disbalancave, sqarojmë se tregu i disbalancave dhe llogaritjet bëhen në *ex post*, është e pamundur në *ex ante* të bëhen llogaritjet e kostove të disbalancave, pasi tregu është dinamik dhe me kosto të cilat variojnë në baza orare dhe ditore.

- Lidhur me pretendimet e shprehura nga AREA mbi përcaktimet e VKM-së nr. 480/2018, vlerësojmë se ERE, nëpërmjet vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106/2020, ka miratuar rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit për të gjithë pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike. Vendimi nr. 106/2020, nuk përcakton në asnjë rast se cilat janë palët përgjegjëse për balancimin, ky përcaktim gjendet në aktet ligjore në fuqi, respektivisht në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe ligjin nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

- Gjithashtu në nenin 98, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se: “ERE miraton rregullat e tregut të energjisë elektrike, në përputhje me këtë ligj dhe modelin e tregut të energjisë elektrike, ku përfshihen rregullat për planifikimin, dispeçerimin, balancimin, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe kërkesat për menaxhimin e rezervës. Për sa më lart, sqarojmë se ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nuk kushtëzon

miratimin e këtyre rregullave nga ana e ERE-s edhe pas daljes së vendimeve të Këshillit të Ministrave për përjashtimin nga disbalancat.

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020, vendosi miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, ndërsa me vendimin nr. 275, datë 28.12.2020, “Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për shtyrje të afatit të hyrjes në fuqi të vendimit nr. 106, datë 2.7.2020”, ndër të tjera vendosi se OST sh.a. dhe pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike të vijojnë aplikimin e periudhës *dry run* deri në datën 31.3.2021. Këto dy vendime kanë përcaktuar edhe kohën e hyrjes në fuqi të “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës së shoqatës AREA për shtyrjen e afatit të hyrjes në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, “Mbi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” me një periudhë shtesë 9-mujore, minimalisht deri më 31.12.2021.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqatën AREA për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 256 lekë